

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

**PROJEKTI: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te
Brendshme Fshati Shtermen'**

Bashkia Cërrik"

2025

**Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'**

PËRMBAJTJA:

1. HYRJE	4
2. SHPJEGIMI I AKRONIMEVE	5
3. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM-SË DHE METODIKËN E ZBATUAR.....	8
A. Përshkrim të qëllimit dhe objektivave të VNM-së.....	8
B. Objektivat afatshkurter te VNM jane:.....	8
C. Objektivat afatgjate te VNM jane:.....	9
D. Përshkrim të përmbledhur të kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin.....	10
E. Kuadri institucional.....	13
4. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	15
A. Përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar.	15
B. Pershkrimi i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi.....	22
C. Informacion rreth zonave te mbrojtura te rajonit.....	24
D. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative, ne mjedis, te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer.	25
1. Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte).....	25
2. Mjedi social –ekonomik:.....	25
3. Ndikimet në ujë	26
3. Ndikimet në tokë	28
4. Ndikimet në ajër	28
5. Shkarkimi i mbetjeve	30
Ndikimi në komunitet, Shëndeti dhe Siguria	33
5. Te dhena per shtrirjen e mundshme hapsinore te ndikimeve negative ne mjedis, qe nenkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te.	37
6. Mundësia e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot e peraferta per rehabilitimin.....	38
7. Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis.....	50
1. Masat për mbrojtjen e argjinaturës dhe të pjerrësisë.....	50
2. Masat për kampet e ndërtimit dhe për objektet e ngjashme.....	50
3. Masat zbutese per ndikimet ne biodiversitet.....	50
4. Masat zbutese per ndikimet ne ujrat nëntoksore	51
5. Masat zbutese per ndikimet ne Ujërat sipërfaqësore.....	51

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

6.	Masat zbutese per ndikimet ne Cilesine e tokës.....	52
7.	Tektonia dhe sizmiciteti	52
8.	Gjeologjia	52
9.	Masat zbutese per ndikimet ne cilesine e ajrit	53
10.	Masat zbutese per ndikimet ne Zhurma.....	53
11.	Masat zbutese per ndikimet ne Vibrimet	55
12.	Masat zbutese per ndikimet ne Peisazh dhe çeshtjet vizuale	56
13.	Masat zbutese per ndikimet nga Përmbytje	56
8.	Çështjet socio-ekonomike.....	56

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

1. HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobeseve ne menyre te pashmangshme krijon dhe "produkte" qe ne perfundim mund te sjelli probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresish nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e çdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje, toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes.

Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njeiten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara, emetimet e gazeve të dëmshëm ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me pastër mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme.

Raporti i *Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis* siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim dhe zbatim te projektit.

Ndikimi - efekti i një projekti që ka në mjedisin rrethues

Vlerësimi - analiza që i bëhet këtij projekti

Mjedisi - elementet abiotike dhe biotike

VNM përfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qendrueshmërisë së mjedisit. Mbrotjtja e mjedisit, si nje sistem dinamik, duhet pare ne teresine e faktoreve

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

natyror, dhe te veprimi njerezor qe ushtrohen mbi te. Ato kane nje efekt te fuqishem mbi kushtet e jeteses se popullsise, dhe jane nje element baze per krijime te favorshme ekonomike.

Kur parametrat mjedisore nuk janë konform ligjeve, normave dhe rregullave të mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje të tij dhe prishje të ekuilibrave natyror.

Nxitja e zbatimit te ketyre normave kerkon nje perkujdesje nga ana e organeve legjislative dhe vendimmarrese, ne menyre qe te rritet interesi si dhe detyrimi per ruajtjen e ekuilibrave natyror.

Kjo është arritur duke:

- o Dhënë gjendjen reale nga pikëpamja e ndikimit të këtij aktiviteti në mjedisin human.
- o Analizuar faktorët pozitivë dhe negativë mjedisor.
- o Dhënë rekomandimet për masat zbutëse dhe minimizimin e ndikimeve negative në mjedis.

Për këtë është:

- o Shfrytëzuar dokumentacioni juridik dhe teknik të subjektit
- o Shfrytëzuar informacioni baze i zone

2. SHPJEGIMI I AKRONIMEVE

- o **"MTM"** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- o **"OKB"** Qendra Kombetare e Biznesit
- o **"AKBN"** Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore
- o **"VKM"** Vendim I Keshillit të Ministrave
- o **"MIE"** Ministria e Infrastruktures dhe Energjise
- o **"AKM"** Agjensia Kombetare e Mjedisit
- o **"OIF"** Organizata Jo Fitimprurese
- o **"NIOV"** Njesi e Qeverisjes Vendore
- o **"DRM"** Drejtoria Rajonale e Mjedisit

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

- **"Cilësi e mjedisit"** është gjendja e mjedisit apo e një përbërësi të tij në një kohë të caktuar, e shprehur nëpërmjet treguesve fizikë, kimikë, biologjikë, estetikë apo të tjerë.
- **"Dëmtim i mjedisit"** është dëmi i kryer ndaj mjedisit apo humbja e funksionit natyror të pjesëve përbërëse të mjedisit, shkaktuar nga humbja e ndonjë prej përbërësve të tij, nga ndërhyrjet nga njeriu ndaj lidhjeve të përbërësve të mjedisit dhe/ose rrjedhës natyrore të zhvillimit të tyre.
- **"Kapacitet bartës"** është kapaciteti i mjedisit për të pranuar ndryshimet e shkaktuara nga faktorët e jashtëm, duke ruajtur, në të njëjtën kohë, vetitë e tij natyrore.
- **"Mjedis"** janë përbërësit natyrorë: ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu.
- **"Mjedis i kërcënuar"** është mjedisi i një zone të caktuar nën efektin e trysnisë së një ndotjeje të konsiderueshme.
- **"Ndërhyrje negative në mjedis"** është çdo veprim i përkohshëm apo i vazhdueshëm i njeriut, që mund të prekë kapacitetin bartës të mjedisit apo biodiversitetin e tij, ose që ka ndikime të dëmshme mbi mjedisin.
- **"Ndotje"** është futja e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit.
- **"Subjekt ndotës ose ndotës"** është çdo person fizik apo juridik, veprimtaria e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e të cilit shkakton ndotjen e mjedisit.
- **"Substancë e rrezikshme"** është një substancë apo grup substancash, të cilat janë toksike, të qëndrueshme dhe me prirje për t'u akumuluar biologjikisht në mënyrë të natyrshme, si dhe substanca apo grupe të tjera substancash, të cilat paraqesin rrezikshmëri të ngjashme.
- **"Shkarkim"** është lëshimi i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë i substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë ose zhurmës nga burime të veçuara apo të përhapura në ajër, ujë ose tokë, si pasojë e veprimtarisë njerëzore.
- **"Gjendje e pranueshme e mjedisit"** është gjendja në të cilën mjedisi i vendit në fjalë ishte para se instalimi të vihej në operim. Arritja e kësaj gjendjeje kërkon masa që përfshijnë, por nuk kufizohen me: largimin e të gjitha mbetjeve që kanë tepruar, largimin sa më shumë të jetë e mundur të çdo lloj ndotjeje, dhe, aty ku ky largim nuk do të thotë trajtim praktik apo stabilizim i ndotjes, rehabilitimin e çdo dëmi që mund të ketë shkaktuar ndotja, si dhe zbutjen e efekteve të çdo dëmi.
- **"Instalim"** është çdo njësi teknike e palëvizshme, që kryen një ose shumë veprimtari, si dhe çdo lloj tjetër veprimtarie që lidhet drejtpërdrejt me të apo ka një lidhje teknike me

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

veprimtaritë e zhvilluara në njësinë e mësipërme dhe që mund të ndikojë në shkarkimet dhe ndotjen;

- o **"Instalim ekzistues"** është: a) një instalim që është në funksionim në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji; b) një instalim që nuk është vënë ende në funksionim në datën kur ky ligj hyn në fuqi, por për të cilin është dhënë leja e ndërtimit, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10 119 datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", dhe ndërtimi i të cilit fillon brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- o **"Instalim i ri"** është: a) një instalim që nuk është instalim ekzistues; b) një instalim ekzistues, për funksionimin e të cilit operatori nuk ka kërkuar pajisjen me lejen përkatëse të mjedisit, brenda periudhës kohore të përcaktuar në këtë ligj. Në këtë rast, ky instalim trajtohet si një instalim i ri.
- o **"Normat e cilësisë së mjedisit"** është një grup kushtesh që duhen përmbushur në një kohë të dhënë nga një mjedis i caktuar ose një pjesë e veçantë e tij, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".
- o **"Substancë"** është çdo element kimik dhe përbërjet e tij, me përjashtim të substancave radioaktive dhe të organizmave të modifikuar gjenetikut, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".
- o **"Shkarkim në ujë"** janë shkarkimet në trupat ujorë, ku përfshihen shkarkimet në rrjetin e tubacioneve të ujërave të zeza e të bardha.
- o **"Teknikat më të mira të disponueshme (TMD)"** është stadi më efektiv dhe më i përparuar i zhvillimit të veprimtarive dhe të metodave të operimit të tyre. Ky stad tregon se sa të përshtatshme janë praktikisht teknikat e veçanta për të siguruar, në parim, bazën për të përcaktuar vlera kufi të shkarkimeve, të tilla që të parandalojnë dhe, kur nuk është praktikisht e mundur, të pakësojnë shkarkimet në përgjithësi dhe ndikimin mbi mjedisin në tërësi.
- o **"Biomasa"** është produkt i përbërë, tërësisht ose pjesërisht, nga material bimor nga bujqësia ose pemëtaria, që mund të përdoret si lëndë djegëse, me qëllim rikuperimin e energjisë së përmbajtur në të.
- o **"Vlera kufi e shkarkimit"** është sasia e lejueshme e një substance në masën e gaztë të shkarkuar në ajër nga instalimi me djegie, gjatë një periudhe të dhënë. Sasia e substancës llogaritet në terma të masës/për vëllim të gazeve të shkarkuara, të shprehura në mg/Nm³, duke konsideruar një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara: prej 3 për qind, në rastin e karburanteve të lëngshme e të gazta, 6 për qind në rastin e karburanteve të ngurta dhe 15 për qind në rastin e turbinave me gaz.
- o **"Projekt" është:**
 - Zbatimi i punimeve të ndërtimit apo instalimeve ose skemave të tjera;
 - Ndërhyrje të tjera në mjedisin dhe peizazhin natyror, përfshirë edhe ndërhyrjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e mineraleve.
- o **"Zhvillues"** është personi ose autoriteti publik që kërkon miratim për të zhvilluar një projekt privat apo publik.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

- **"Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)"** është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekte të propozuara publike dhe private.
- **"Publiku"** ka kuptimin që jepet në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".
- **"Publik i ndikuar"** është publiku i prekur ose që mund të preket, apo publiku që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore, përfshirë edhe OJF-të mjedisore që shprehin interes.
- **"Vendim"** është dokumenti zyrtar i lëshuar nga AKM-ja, në të cilin është vendosur nëse një projekt i shtojcës II duhet apo jo t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së.
- **"Deklarata për ndikimin e një projekti në mjedis"**, më poshtë "Deklarata mjedisore", është dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministri, për vlerësimin mjedisor të projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis dhe shërben si dokument orientues për autoritetin e planifikimit dhe/ose çdo autoritet përgjegjës në procesin e vendimmarrjes, për një leje zhvillimi apo për një leje të caktuar dhe që përfshihet në kategorinë III.1 të shtojcës që i bashkëlidhet ligjit Nr.10 081, date 23.2.2009 "Për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë".
- **"Vlerësim ndërkufitar i ndikimeve në mjedis"** është procesi i VNM-së, që zhvillohet për projekte ose veprimtari, të përcaktuara në aneksin I të Konventës së Kombeve të Bashkuara (ESPOO) "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar", që, bazuar nga vendndodhja e teknologjia e tyre, mund të kenë ndikime të ndjeshme negative në mjedisin e shteteve fqinje apo të vendit tonë.
- **"Ekspert i certifikuar i VNM-së"** është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor

3. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM-SË DHE METODIKËN E ZBATUAR

A. Përshkrim të qëllimit dhe objektivave të VNM-së

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte hartuar bazuar ne legjislacionin mjedisor per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis dhe ka per qellim qe te identifikojë, parashikojë, vleresojë dhe parandalojë apo minimizojë ndikimin ne mjedis te projektit ne zhvillim.

B. Objektivat afatshkurter te VNM jane:

- a) Permiresim nga pikepamja mjedisore te projektit te propozuar;
- b) Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

- c) Siguron qe eshte perzgjedhur alternativa me e mire e vendodhjes se projektit;
- d) Siguron qe jane marre ne konsiderate teknikat me te mira te disponueshme te teknologjise se propozuar per tu aplikuar;
- e) Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit te propozuar;
- f) Mundeson informimin e vendimmarresve, duke gjykuar ne miratimin ose jo te projektit dhe kushteve qe duhet te vendosen ne aktin e miratimit.

C. Objektivat afatgjate te VNM jane:

- a) Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- b) Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimet e pakthyeshme te mjedisit;
- c) Ndikon ne mbrojtjene burimeve natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- d) Permireson aspektet sociale-ekonomike te projektit;
- e) Ndhmon ne realizimin e parimit te zhvillimit te qendrueshem te mjedisit.

Strukturimi i këtij raporti është berë në përputhje me kriteret për këtë qëllim të përcaktuara në Kreun I, pika 1.2 si dhe të shtojcës I, të VKM nr.686, datë 29.7.2015, për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekte të propozuara publike dhe private.

Pergatitja e ketij raporti është në përputhje me kërkesat e VKM me nr.686, date 29.7.2015 “Përmiratimi ne rregullave, të përgjegjësi e të afate vepër zhvillimin e procedures së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedures së transferimit të vendimite deklaratës mjedisore”

Raport i përmbledhur i vlerësimit të ndikimit në mjedis ka si qëllim:

- o Identifikimim dhe parashikimin e ndikimeve të mundshme pozitive dhe negative në mjedis si rezultat i zbatimit të projektit të propozuar;
- o Evidentimin e sigurimin e masave që zbusin ose kompensojnë ndikimet negative në mjedis si rezultat i zbatimit të këtij projekti.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

D. Përshkrim të përmbledhur të kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin.

- o Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 **"Për Mbrojtjen e Mjedisit"**
- o Ligji Nr. 53/2020, Ndryshimi i Ligjit Nr. 10431 datë 9.6.2011 **"Për Mbrojtjen e Mjedisit"**
- o Ligji Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 **"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"**
- o Ligji Nr. 12/2015 për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7.2011, **"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"**
- o Ligji Nr. 128/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7.2011, **"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"** të ndryshuar
- o Udhëzim **"Për tarifat për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis "**
- o Vendim Nr.13, datw 4.1.2013 **"Për miratimin e rregullave, të përgjegjëseve e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis"**
- o Vendim Nr. 598, datë 1.7.2015 **"Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar "**
- o Vendim Nr. 686, datë 29.7.2015 **"Për miratimin e rregullave, të përgjegjëseve e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"**
- o Vendim Nr. 95, datë 14.2.2018 për disa ndryshime në Vendimin Nr. 686, datë 29.7.2015, të këshillit të ministrave, **"Për miratimin e rregullave, të përgjegjëseve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"**
- o VENDIM Nr. 828, datë 28.12.2023 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 686, datë 29.7.2015,
- o Vendim Nr. 912, datë 11.11.2015 **"Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis "**
- o Ligj Nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 111/2012 **"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"**
- o Ligj Nr.9587, datë 20.7.2006 **"Për mbrojtjen e biodiversitetit ", i përditësuar**
- o Ligj Nr. 68/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9587, datë 20.7.2006 **"Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar**
- o Ligj Nr. 41/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9587, datë 20.7.2006, **"Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar**
- o Ligj Nr. 11/2012 **"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"**
- o Ligji Nr. 9774, datë 12.07.07 **"Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"**
- o Ligj Nr.10 006, datë 23.10.2008 **"Për mbrojtjen e faunës së egër "I përditësuar**
- o Projektligj për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 006, datë 23.10.2008 **"Për mbrojtjen e faunës së egër", të ndryshuar**

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

- Ligj Nr. 10 433, datë 16.06.2011 **"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"**
- Ligj Nr.9587, datë 20.7.2006 **"Për mbrojtjen e biodiversitetit", i përditësuar**
- Ligj 111/2012 **"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"**
- Ligj Nr. 10 433, datë 16.06.2011 **"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"**
- Udhëzim Nr.8, datë 27.11.2007 **"Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara"**
- Udhëzim Nr.1037/1, datë 12.4.2011 **"Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore"**
- Urdhër Nr. 77, datë 2.7.2020 **"Për dorëzimin e raporteve në Agjensinë Kombëtare të Mjedisit"**
- Vendim Nr. 1189 **"Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit"**
- Vendim Nr.177, datë 31.3.2005 **"Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse"**
- Vendim Nr. 587, datë 07.07. 2010 **"Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike"**
- Vendim Nr. 247, datë 30.04.2014 **"Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"**
- VKM Nr.994, datë 02.07.2008 **"Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin".**
- Vendim Nr. 742, datë 9.9.2015 **"Për funksionimin dhe menaxhimin e regjistrit të shkarkimit e të transferimit të ndotësve, miratimin e listës së veprimtarive dhe të ndotësve, që janë subjekt i këtij regjistri"**
- VKM 434 date 08.06.2016, **"Për Rregullat Për paraqitjen E Kërkesës, Mbajtjen Dhe Plotësimin E Dokumentacionit Teknik, Kriteret Dhe Proçedurat E Zvogëlimit Të Sipërfaqes Dhe Të Vëllimit Të Fondit Pyjor",**
- Ligji Nr. 10 463 **"Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve"**
- Ligji Nr.118/2012 **"Për transportin e mallrave të rrezikshme"**
- Ligji Nr.156, datë 10.10.2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr.10463, datë 22.9.2011, **"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar**
- Udhëzim Nr. 1738, datë 12.03.2015 **"Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vendepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e landfillleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane"**
- Urdhëri Nr. 135, datë 16.04.2015 **"Mënyra e administrimit kombëtar të transfertave të mbetjeve të rrezikshme"**
- VKM Nr.232, datë 26.04.2018 e ndryshuar **"Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"**
- VKM Nr.319 datë, 31.05.2018 **"Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"**

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

- VKM N. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- VKM Nr. 608, datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"
- VKM Nr. 652, datë 14.09.2016 "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura"
- Vendimi Nr. 99/2005 "Për katalogun e mbetjeve" e përditësuar
- Vendim Nr. 402, datë 30.06.2021 "Për miratimin e katalogut të mbetjeve".
- Vendimi Nr.319, datë 31.5.2018 "Për kostot dhe tarifën e mbetjeve"
- Vendim Nr.52, datë 05.02.2014 "Për disa ndryshime të Vkm Nr. 117 "Skrapet"
- Vendim N. 117, datë 13.02.2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje"
- Vendim Nr. 127, datë 11.02.2015" Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura"
- Vendim Nr. 175, datë 19.01.2011 "Strategjia e planit kombëtar të mbetjeve"
- Vendim Nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme"
- Vendim Nr.333, datë 26.01.2011 "Për administrimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane"
- Vendim Nr. 360, datë 29.05.2015 "Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre"
- Vendim Nr. 371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme"
- Vendim Nr. 389, datë 27.6.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfilllet e mbetjeve"
- Vendim Nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"
- Vendim Nr 452, datë 11.07.2012 "Për lendfillin e mbetjeve"
- Vendim Nr. 687, datë 29.07.2015 "Për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"
- Vendim Nr.705 datë 10.10.2012 "Për automjetet e dala jashtë përdorimit"
- Vendim Nr.765, datë 07.11.2012 "Për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorur"
- Vendim Nr. 798, datë 29.09.2010 "Për mbetjet spitalore"
- Vendim Nr. 866, datë 04.12.2012 "Mbetjet e baterive dhe akumulatorëve"
- Vendim Nr. 957, datë 19.12.2012 "Për mbetje nga pajisjet elektrike dhe elektronike"
- Vendim N.967, datë 25.10.2013 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të komitetit të menaxhimit të integruar të mbetjeve"

Raporti Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

- Vendim Nr.1104, datë 28.12.205 "Për miratimin e kërkesave për parandalimin e shkarkimit të mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat, në det"
- Vendim Nr. 660, datë 31.10.2018 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve të metaleve".
- Ligji Nr. 57/2020 "Për pyjet"
- Ligji Nr. 5/2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë "
- Ligji Nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura "
- Ligji Nr. 68/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar.
- VKM Nr. 303, datë 10.5.2019 "Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të Monumenteve të Natyrës Shqiptare".
- Ligji Nr. 10 266, datë 15.04.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".
- Ligji Nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis".
- Ligji Nr. 27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve"
- Ligji Nr. 155/2020 "Për ndryshimet klimatike"
- Ligji Nr. 124/2015 datë 12.11.2015 "Për efikasitetin e energjisë".
- Ligji Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".
- Ligji Nr. 9244, Date 17.06.2004 "Per mbrojtjen e tokes bujqesore".
- Ligji Nr. 10 304, date 15.07.2010" Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar.

E. Kuadri institucional

Institucionet pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit Nje pjese e madhe e legjislacionit, perfshire ligjin mbi mbrojtjen e mjedisit eshte pershtatur tashme, per te ndihmuar ne arritjen e ketyre objektivave. Institucionet jane organizuar ose po organizohen per te monitoruar dhe zbatuar ligjet, por ka ende nje pune te gjate per te bere, drejt arritjes se qendrueshmerise. Institucioni kryesor dhe me i rendesishem ne fushen e mjedisit eshte Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Ne varesi te kesaj Ministrie jane edhe Agjencia Kombetare e Mjedisit, Drejtorite Rajonale te Mjedisit, si dhe Drejtorite Rajonale te Menaxhimit te Pyjeve. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit eshte e perbere nga 4 Drejtori Rajonale te Mjedisit te cilat ushtrojne funksion lokal ne rang prefektore dhe Agjencia Kombetare e Mjedisit e cila ka funksion kombetar.

Institucione te tjera pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit jane edhe Pushteti vendor, si dhe Ministri te tjera si ajo e Transporteve, e Bujqesise, Ministria e Energjise dhe Industrise, etj, sipas fushes se veprimtarise. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) eshte autoriteti kryesor pergjegjes per menaxhimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe hartimin e politikave

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

mjedisore ne nivel kombetar. Ministria e Mjedisit u krijua si organi shtetror i specializuar per mbrojtjen e mjedisit ne Shqiperi. Ajo harton dhe zbaton politiken e qeverise per mbrojtjen e mjedisit, harton projekt-akte ligjore e nen-ligjore ne fuksnion te mbrojties dhe menaxhimit te qendrueshem te mjedisit, bashkerendon aktivitetet e institucioneve te linjes per ceshtje te mjedisit, organizon dhe koordinon punen per monitorimin e mjedisit, pergatit projekt-marreveshjet nderkombetare apo bilaterale per mbrojtjen e mjedisit, pergatit Raportin vjetor "Per Gjendjen e Mjedisit", shqyrton dhe jep aktet e miratimit te lejeve mjedisore per aktivitetet e ndryshme ekonomike, etj.

Ne baze te ligjit per mbrojtjen e mjedisit, neni 67, pergjegjesite kryesore te MTM jane: Si institucion qendror i specializuar per mbrojtjen e mjedisit dhe si mbeshtetese teknike e Ministrit, Ministria kryen edhe keto detyra kryesore:

Bashkepunon me institucionet qendrore, me organet e qeverisjes vendore, me publikun dhe organizatat joqimprurese mjedisore e profesionale, per te rritur shkallen e zbatimit te legjislacionit mjedisor; Pergatit projektet e marreveshjeve, te protokolleve e programeve te bashkepunimit dy e shumepalesh, me shtete, organe dhe organizata nderkombetare per mbrojtjen e mjedisit dhe ndjek zbatimin e tyre;

Studion nevojat e vendit per specialiste per mbrojtjen e mjedisit dhe bashkerendon me Ministrine e Arsimit dhe Shkences per kualifikimin e specializimin e tyre; Mbeshtet projekte per punë kërkimore-shkencore, per permiresimin e gjendjes se mjedisit, per futjen e teknologjive ekologjikisht te pastra, per nxitjen e veprimtarive te organizatave joqimprurese mjedisore; Ndihton organet e qeverisjes vendore per mbrojtjen e mjedisit dhe per hartimin e zbatimin e planeve vendore per mjedisin. Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM)

Ne ligjin per mbrojtjen e mjedisit, Nr. 10431, date 09.06.2011, ne Nenin 59 "Organizimi i Agjencise Kombetare te Mjedisit" percaktohet:

- o Agjencia Kombetare e Mjedisit eshte institucion qendror publik ne varesi te ministrit, qe ushtron juridiksionin e vet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, permes zyres qendrore dhe degeve rajonale ne qarqe, te cilave ketu e me poshte do t'u referohemi si agjencite rajonale te mjedisit.
- o Agjencia Kombetare e Mjedisit financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e veta.
- o Agjencia Kombetare e Mjedisit ka pavaresi ne vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve te saj, te parashikuara ne kete ligj. Keshilli i Ministrave, ne perputhje me kerkesat e ketij ligji, miraton rregulla te hollesishme per organizimin dhe funksionimin e Agjencise Kombetare te Mjedisit dhe te agjencive rajonale te mjedisit, ndarjen dhe organizimin e punee, statusin e punonjesve dhe marredheniet e saj me institucione te tjera. Kryeministri, me propozimin e ministrit dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, miraton strukturen dhe organiken e Agjencise Kombetare te Mjedisit dhe te agjencive rajonale te mjedisit. Ndersa ne Nenin 60, te

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

ketij ligji percaktohen funksionet e ketij institucioni. Funksionet e Agjencise Kombetare te Mjedisit:

1. Agjencia Kombetare e Mjedisit eshte autoriteti kompetent per percaktimin e kushteve per lejet perkatese te mjedisit, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, me legjislacionin per lejet e mjedisit dhe me dispozitat e ligjeve te tjera perkatese dhe ka këto funksione:
 - Hartimin e Programit Kombetar per Monitorimin e Mjedisit dhe monitorimin e gjendjes se mjedisit, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji;
 - Pergatitjen dhe publikimin e raporteve vjetore per gjendjen e mjedisit;
 - Kryerjen e sherbimeve te matjes se shkarkimeve ne mjedis me kerkese te ministrise;
 - Keshillimin e organeve vendore per zbatimin e politikave mjedisore;
 - Krijimin dhe menaxhimin e sistemit te informacionit mjedisor;
 - Krijimin dhe menaxhimin e Regjistrit te Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotsve;
 - Sigurimin e informacionit mjedisor per publikun, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji;
 - Sigurimin e informacionit per publikun per procesin e vendimmarrjes per ceshtjet mjedisore, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji;
 - Sigurimin e zbatimit te parimit te pergjegjesise mjedisore per cdo operator, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji;
 - Menaxhimin e sistemit te te dhenave per pyjet.

2. Kjo agjenci kryen edhe funksione te tjera qe i ngarkohen me legjislacion te posacem. Ne nivel rajonesh veprojne 4 Agjensi Rajonale te Mjedisit (ARM), te cilat nepermjet ndryshimeve ligjore te muajve te fundit, kalon ne varesi te AKM. ARM-t i kryejne funksionet dhe kompetencat brenda territorit te nje rajoni te caktuar duke perfshire te gjitha rrethet dhe komunat e bashkite e ketyre rajonve.

4. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

A. Përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar.

Qellimi i projektit konsiston ne permiresimin e mjedisit urban, krijimin e hapësirave me miqesore per funksionimin e kesaj rruge si infrastrukture e mirefillte bashkekohore dhe kthimin e saj ne sherbim te komunitetit.

Gjatesia totale e rrjetit te rrugëve e permbledhur eshte rreth 1186.13 ml.

**Raporti Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'**

SISTEMI KOORDINATIV UTM				
			x	y
Segmenti nr.1	Kordinatat e Fillimit	1.00	4,540,514.97	416,709.86
	Kordinatat e Mbarimit	2.00	4,540,735.56	416,575.40
Segmenti nr.2	Kordinatat e Fillimit	3.00	4,540,322.42	416,904.30
	Kordinatat e Mbarimit	4.00	4,540,382.54	416,997.41
Segmenti nr.3	Kordinatat e Fillimit	5.00	4,540,279.87	417,058.87
	Kordinatat e Mbarimit	6.00	4,540,482.36	416,890.84
Segmenti nr.4	Kordinatat e Fillimit	7.00	4,539,783.76	417,725.30
	Kordinatat e Mbarimit	8.00	4,539,656.43	417,978.01
Segmenti nr.5	Kordinatat e Fillimit	9.00	4,539,221.55	416,844.36
	Kordinatat e Mbarimit	10.00	4,539,080.32	416,630.76



Plani i segmenteve te rrugëve te fshatit Shtermen

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

POZICIONI I OBJEKTIT

Pozicioni gjeografik: Zona e nderhyrjes ndodhet ne teritorin e Bashkine Cerrik
Vendndodhja: Bashkia Cerrik, Fshati Shtermen

GJENDJA EKZISTUESE

Rrugët e fshatit Shtërmen, në territorin administrativ të Bashkisë Cërrik, paraqiten aktualisht në gjendje të amortizuar dhe me probleme të theksuara funksionale. Traseja ekzistuese është kryesisht me gjerësi të kufizuar, me shtresë të dëmtuar ose të munguar, ndërsa në disa segmente rruga paraqitet vetëm me terren natyror të shfrytëzuar nga qarkullimi i mjeteve. Në periudhat me reshje, rrugët bëhen të vështira për t'u përshkuar për shkak të formimit të gropave, deformimeve sipërfaqësore dhe përqendrimit të ujërave, si pasojë e mungesës së sistemit të kanalizimit të ujërave të bardha. Gjatë segmenteve të ndryshme vërehet mungesë e bordurave, rigolave dhe elementëve të tjerë ndihmës të infrastrukturës rrugore, duke ndikuar negativisht në sigurinë, komoditetin dhe jetëgjatësinë e rrugës. Gjendja aktuale kërkon ndërhyrje të menjëhershme për rikonstrukcion dhe përmirësim të parametrave gjeometrikë dhe inxhinierikë të rrjetit rrugor të fshatit.

Gjendja ekzistuese Segmenti nr. 1



Gjendja ekzistuese Segmenti nr. 2&3

**Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'**



Gjendja ekzistuese Segmenti nr. 4



Gjendja ekzistuese Segmenti nr. 5



Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

Te dhena mbi Projektin

Objekti kryesor i projektit "Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen, Bashkisë Cërrik" është përmirësimi i infrastrukturës rrugore me qëllim rritjen e aksesit, përsheptimin e lëvizjes dhe rritjen e sigurisë për komunitetet lokale. Ndërhyrja synon të krijojë kushte optimale për qarkullimin e mjeteve dhe këmbësorëve, duke reduktuar ndjeshëm kohën e udhëtimit dhe kostot e transportit të mallrave dhe produkteve bujqësore. Përmirësimi i rrugëve ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të zonës, pasi u mundëson fermerëve lidhje më efikase me tregjet lokale dhe rajonale, si dhe shton mundësitë për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe shërbimeve.

Nga ana sociale, projekti synon të rrisë cilësinë e jetës së banorëve të fshatit Shtermen duke lehtësuar aksesin drejt institucioneve arsimore, qendrave shëndetësore dhe shërbimeve publike të Bashkisë Cërrik. Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme përmirëson ndjeshëm sigurinë në transport, redukton izolimin e fshatit gjatë periudhave me reshje dhe krijon kushte më të mira për qarkullimin e mjeteve të banorëve, transportin publik dhe shërbimet emergjente. Ndërhyrja ndikon pozitivisht në uljen e migrimit të brendshëm, duke rritur komoditetin dhe atraktivitetin e zonës për familjet dhe të rinjtë që jetojnë aty.

Nga aspekti zhvillimor dhe ekonomik, fshati Shtermen ka potencial të konsiderueshëm rural dhe bujqësor, si dhe burime natyrore që mund të shfrytëzohen për aktivitete rekreative dhe turizëm lokal. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore siguron akses më të lehtë për vizitorët dhe bizneset, duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin e agroturizmit, prodhimit vendas dhe shërbimeve mbështetëse. Investimi në këtë infrastrukturë përbën një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të zonës dhe rritjes së të ardhurave në nivel komuniteti.

Duke qenë se objekti në studim ndodhet në një zonë rurale me një rrjet ekzistues rrugor të formuar prej vitesh, projekti nuk parashikon ndryshim të trasimit aktual. Traseja e rrugëve do të ruhet siç është, duke kryer vetëm skarifikimin e shtresës sipërfaqësore dhe, kur është e nevojshme, gërmime të pjesshme në mënyrë që nivelet e rrugës të mos ngrihen mbi kuotat e portave hyrëse të banesave. Në trasenë ekzistuese do të shtrohen shtresat sipas projekt-zbatimit, duke siguruar rrafshim dhe mbajtje të duhur konstruktive. Gjithashtu, projekti parashikon zëvendësimin e disa tubinave ekzistuese të amortizuara, të cilat do të identifikohen në terren gjatë fazës së zbatimit nga supervizori dhe kontraktori.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

Në zgjidhjen e projektit janë patur parasysh:

- Zgjidhja në anën Planimetrike,
- Zgjidhja në anën Altimetrike
- Elementet sociale

Zgjidhja në anën Planimetrike,

Zgjidhja planimetrike e projektit është konceptuar duke ndjekur gjurmët ekzistuese të rrugëve në të gjitha segmentet e fshatit Shtermen, me qëllim minimizimin e ndërhyrjeve në terren dhe shkaktimin e sa më pak ndikimesh në pronat përreth. Gjurma e secilit aks ruhet brenda koridorit aktual rrugor, ndërsa janë kryer korrigjime të lehta të vijës së planimetrisë në zona të kufizuara ku gjerësia ekzistuese është e pamjaftueshme ose ku terreni paraqet deformime. Gjerësia e projektuar e platformës rrugore është përcaktuar në intervalin 4.5-5.0 m, e mjaftueshme për kalimin e mjeteve në dy drejtime në zona urbane dhe për një drejtim me pika anashkalimi të studiuara në zonat më të ngushta rurale. Në kthesat e ndjeshme janë respektuar rrezet minimale të nevojshme për siguri dhe qarkullim normal të mjeteve. Sinjalistika horizontale dhe vertikale do të vendoset sipas kërkesave të Kodit Rrugor, duke përfshirë shenja orientimi, kufizime shpejtësie dhe elemente paralajmëruese në zona me vizibilitet të reduktuar. Zgjidhja planimetrike synon të sigurojë një lidhje të qëndrueshme dhe funksionale midis qendrave të banuara dhe rrjetit kryesor rrugor të bashkisë.

Zgjidhja në anën Altimetrike

Zgjidhja altimetrike e projektit është hartuar duke marrë në konsideratë topografinë karakteristike kodrinore të zonës së Dumresë, me qëllim arritjen e pjerrësive të pranueshme dhe funksionale në të gjithë gjatësinë e segmenteve. Profili i gjatësisë është projektuar për të siguruar pjerrësi gjatësore brenda intervalit 2-8%, ndërsa në zona të veçanta kodrinore me terren të theksuar janë lejuar pjerrësi deri në 10%, por duke marrë masa mbrojtëse dhe elemente drenazhi për të shmangur erozionin. Janë eliminuar gropat, deformimet dhe thyerjet e papritura në vijën e gjatësisë duke realizuar një profil të rregullt e të vazhduar, i cili përmirëson komoditetin dhe sigurinë e qarkullimit. Për çdo segment është projektuar sistem drenazhimi anësor nga të dyja krahët, duke përfshirë rigola betoni, tombina në kryqëzime ujërash dhe shkarkime të kontrolluara në pika të sigurta. Trashësitë e shtresave rrugore janë dimensionuar mbi bazën e kushteve gjeoteknike të terrenit, ndërsa mbështetja altimetrike siguron që rruga të jetë e qëndrueshme ndaj kushteve atmosferike, sidomos gjatë stinës së shirave.


Profili Gjatësor

Profili gjatësor perfaqëson prerjen e rrugës sipas aksit të saj në drejtimin vertikal. Profili gjatësor është hartuar në shkallë Horizontale 1:1000 dhe shkallë Vertikale 1:100.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

Në të janë paraqitur:

Aksi eshte projektuar sipas permasave te meposhtme:



Prerje tip nr 1

Kanalizimet e ujrave të bardha

Ndërtimi i kanaleve të ujrave të bardha, do të projektohet i tillë që të lidhjet me rrjetin e kanalizimit ekzistues.

Për sasitë e ujrave të shiut do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik dhe mënyra e llogaritjes do të paraqitet nga projektuesi në relacionin përkatës.

Siguria Llogaritëse

Siguria llogaritëse e ujrave të shiut do të llogaritet 25 % për kolektorët kryesore dhe 40 % për kolektorët sekondarë.

Vlera e llogaritjes së shiut të merret për periudhë përsëritje 1 herë në vit dhe kohë zgjatje prej 15 minutash (rrebes shiu). Të dhënat dhe llogaritjet e intensitetit të shiut të jenë pjesë e relacionit.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

Materiali kryesor për kanalizimin do të jetë përdorimi i tubave prej polilteni të brinjëzuar të llogaritura për të përballuar ngarkesat ose të jenë prej tubacioni betoni me gota. Pusetat dhe nënobjektet e tjera do të jenë me material betoni të armuar duke eliminuar përdorimin e materialit të tullës në sistemin e kanalizimeve që ka rezultuar me probleme. Kapakët e pusetave do të jenë të tipit kompozit, që ti rezistojë agjentëve atmosferik si dhe ngarkesave të jashtme.

Sinjalistika rrugore

Ne projekt është parashikuar gjithashtu vendosja dhe realizimi i sinjalistikes perkatese horizontale dhe vertikale, ne perputhje me Kodin Rrugor, Rregulloren e Kodit Rrugor dhe Manualeve ne fuqi.

Rruga është paisur me te gjithë vijezeimin e duhur horizontal, ky vijezim është parashikuar te jete bikomponent sprajt per vijezeimet anesore me gjeresi 12cm .

Ne kryqezimet kryesore është parashikuar vendosja e vizimit perkates per kalimin e kembesoreve, me shirita me gjatesi 4m dhe gjeresi 0.5m.

Persa i perket sinjalistikes vertikale ne projekt është parashikuar vendosja e tabelave vertikale rrethore 60cm te cilat detyrojne levizjen me shpejtesi 40km/h ne kete segment rrugor.

Tabelat rrethore 60cm jane vendosur edhe per te ndaluar qendrimin ose parkimin e automjeteve ne te dy anet e rruges ne zonen e banuar.

Ne te gjitha degezimet jane vendosur tabela "STOP" me permasa (A=90, B=30,D=75).

Ne rruget pa dalje është parashikuar vendosja e tabelave 60x60cm te cilat informojne se rruga është pa mundesi dalje.

Per ato rruge te cilat jane te ngushta është parashikuar vendosja e tabelave te cilat informojne per ngushtim rruge dhe si pasoje dhenien ose marjen e perparemise per kalim.

Ne zonat me trotuar me disnivel është parashikuar te vendoset parrmak metalik.

B. Pershkrimi i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi

Sipas Flores se Shqiperise, bimesia e zones perfshihet ne kater zona fitoklimatike te shkurreve dhe pyjeve mesdhetare, te dushqeve, te ahut, dhe te kullotave malore. Ndersa majat e larta te maleve mbulohen me ate te zones se ahut dhe te kullotave paramalore ose malore. Vendet me te sheshta e me te pershtatshme jane zene nga bimesia e

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

kulturave bujqesore: drithera, foragjere, frutikulture etj. Zona e pyjeve dhe e shkurreve mesdhetare shtrihet ne lartesine 300-600 m mbi nivelin e detit.

Keto jane shoqerime bimore te tipit te makies, perhere te blerta, si mare (*Arbutus unedo*), shqope (*Erica arborea*), mersine (*Myrtus communis*), mrete (*Phyllirea latifolia*), shkoze e zeze (*Carpinus orientalis*), lajthi (*Coryllus avellana*), dellinje e kuqe dhe e zeze (*Juniperus oxycedrus*, *J. communis*), thane (*Cornus mas*), fshikekarthe (*Colutea arborescens*), dafine (*Laurus nobilis*) etj. Zona e dushkajave shtrihet ne lartesine 500 (600) - 1'000 (1'300) m (Fig.

12- 15), me perzierje druresh, si shparth (*Quercus frainetto*), qarr (*Q. cerris*), bunge (*Q.*

petraea), bungebute (*Q. pubescens*), frasher (*Fraxinus excelsior*), shkoze (*Carpinus orientalis*), melleze (*Ostrya carpinifolia*), geshtenje (*Casatanea sativa*), lajthi (*Coryllus avellana*), thane (*Cornus mas*), gorrice (*Pyrus amygdaliformis*), rralle ilqe (*Q. ilex*) etj.

Zona e ahut shtrihet ne lartesine 1'000-1'600 m dhe kryesohet nga ahu (*Fagus sylvatica*). Ahu

gjendet ne kufirin me perendimor te arealit te tij, ne grumbuj te thjeshte, deri ne lartesine

1'570 m, si dhe me perzierje llojesh: panje fletegjere (*Acer obtusatum*), melleze (*Ostrya carpinifolia*), bunge (*Q. petraea*), frasher (*Fraxinus excelsior*), pishe e zeze (*Pinus nigra*), rrobull (*P. heldreichii*), hartine (*P. sylvestris*), plep i eger (*Populus alba*), bli (*Tilia platyphyllos*) etj. Ne disa maja mbi 1'000 m, pylli i ahut eshte i paprekur, i virgjjer, pothuajse natyror.

Zona e kullotave malore eshte teper e kufizuar, ne lartesine mbi 1'500 m. Siperfaqe te medha dhe me vlere zene livadhet eumesofile te vendosur ne toka relativisht te thella te murrme pyjore, me *Poa sp. diverse*, *Festuca panciciana*, *Cynosurus crystatus*, *Trifolium pratense*, *Phleum alpinum*, *Koeleria splendens*, *Asphodelus albus*, *Narcissus poeticus*. Çeltirat pyjore dhe siperfaqet zhveshura gurishtore, ne pjesen me te madhe perfaqesohen nga kullota te thata me *Festuca sp. diverse* (*F. bosniaca*), *Bromus sp. diverse* (p.sh. *B. erectus*), *Teucrium montanum*, *Stipa pennata*, *Thymus cherlerioides*, *Th. striatus*. Zene vend te rendesishem

livadhet gjysme te thata (meso-kserofite), me *Agrostis capillaris*, fier (*Pteridium aquilinum*), *Thymus striatus* etj.

Speciet karakteristike te shoqerimit jane: *Platanus orientalis*, *Juglans regia* (vleresuar per prodhimin e fryteve), *Tamarix parviflora*, *Crataegus monogyna* (vleresuar si bime mjekesore). Pasuria llojore eshte e larte, mbi 50 lloje te pranishme. Mjaft e rendesishme eshte, gjithashtu, aftesia per mbrojtjen e tokes nga erozioni.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

Zona ku propozohet projekti ka nje bimesi te zhvilluar, kjo per shkak te mungeses se aktivitetit human per shkak te relievit . Bimesia e dendur e ben ate nje nga zonat me te gjelberuara ne vend. Parku eshte i njohur per pyjet e tij ku gjenden tre kate bimore: shkurret mesdhetare me dy nen katet: makjen (bimet gjithnje te gjelbra si shqopa, mareja, etj) dhe shkozen, dushqet si dhe kati i ahut. Bimesia konsiderohet i paprekur nga njeriu sepse zona perreth zones se projektit eshte bimesi e ulet.

C. Informacion rreth zonave te mbrojtura te rajonit

"Zona të mbrojtura" shpallen territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN.

Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlera shkencore, biologjike, historike dhe didaktike.

Zona ne vlerësim nuk vlerësohet si zone me status te veçante nga MTM. Sic shihet edhe ne

harten e meposhteme, zona ne vleresim nuk permban siperfaqe te mbrojtura. Perverc zonave te mbrojtura sipas hartes se mesiperme te cilat mund te jene te llojit:

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

- Rezeve strikte natyrore/rezerva shkencore/ (Kategori I)
- Park kombetar (Kategori II)
- Monument natyror (Kategori III)
- Rezervat natyror i menaxhuar/zone e menaxhimit te habitateve dhe llojeve (Kategoria IV)
- Peizazh i mbrojtur (Kategoria V);
- Zone e mbrojtur e burimeve te menaxhuara/zone e mbrojtur me perdorim te shumefishte

D. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative, ne mjedis, te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer.

1. Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

Vleresimi i ndikimeve te mundshme si pasoje e zhvillimit te projektit behet duke u nisur edhe nga nje sere faktoresh qe lidhen me natyren e veprimtarise, teknologjine e perdorur, menyren e operimit, sasia e energjise, lendet e para te perdorura dhe mbetjet e gjeneruara te gjitha keto nen konteksin e mjedisit fizik, biologjik dhe socilao – ekonomik. Bilanci perfundimtar i ndikimeve ne mjediset e mesiperme duhet te llogaritet si me poshte: Per nga natyra e veprimtarise dhe per nga natyra se si eshte parashikuar zhvillimi i projektit potencialisht ndikimet me thelbesore mund te analizohen sipas fazave te veprimtarise dhe konkretisht;

- Ne fazen pergatitore/ngritja e kantierit/ instalimeve/ndertimit te infrastruktures mbeshtetese.
- Ne fazen e ndertimit te segmentit rrugor te pershkruar ne projekt
- Ne fazen e mbylljes, rehabilitimit dhe riaftesimit te proceseve natyrore.

2. Mjedisi social –ekonomik:

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

Keto veprimtari mund të ndikojnë në mjedisin social -ekonomik nga:

- Zenia e përkohëshme ose e përhershme e tokës ne funksion te ndertimit te projektit;
- Përdorimi i makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit;
- Përdorimi i materialeve të ndërtimit;
- Përdorimi i karburantit gjatë ndërtimit;
- Gjenerimi i emisioneve në ajër;
- Gjenerimi i zhurmave nga automjetet per ndertimin si dhe i makinerive e pajisjeve që përdoren per ndertimin e projektit;
- Trajtimi dhe depozitimi i mbetjeve të prodhuara.

Kërkesat mjedisore dhe sociale të fazës së venies në funksion dhe të mirëmbajtjes janë:

- Marrja e përhereshme e tokës për ndertimin e gjurmes se re te rruges;
- Gjenerimi i zhurmave nga rritja e pranise se automjeteve;
- Rritja e pranise se banoreve dhe e presionit në mjedisin biofizik.

3. Ndikimet në ujë
- Ujrat nëntoksore

Ndikimet e mundshme mbi ujërat nëntokësore:

- Ndikimet e mundshme mbi ujërave nëntokësore nga punimet e ndërtimit, themelet dhe vepra të tjera të lidhura me tokën;
- Makineritë që punojne në ndërtim dhe kamionet transportues, të cilat mund të sjellin rrezikun e ndotjes nga karburanti dhe vaji.
- Rreziku i ndikimeve negative në ujën në objektet e furnizimit duke përfshirë zona të kufizuara rreth objektit.

Nese nuk merren masa, ndikimet e mundeshme në cilësinë e ujërave nëntokësore janë vlerësuar të moderuar me probabilitet të mesëm e të madhësisë së mesme.

- Ndikimet e mundshme mbi ujërat sipërfaqësore

Ndikimet e mundshme mbi rrjedhat e ujit të lidhura me veprimtaritë pergatitore te sheshit dhe veprimtaritë e ndryshme ndërtimore (ndërtimi i koridoreve hyrëse eventuale, punime tokësore dhe kullimit; makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit; themelet, , përfshijnë:

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

- Rritja e pezullive në ujërat nga germime e dherave.
- Rreziku i mundshëm i ndotjes nga lëndë djegëse si nafta, mbetjet e ngurta, etj;
- Rreziku i ndikimit negativ në objektet e furnizimit me ujë;

Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore janë vlerësuar të ulët, të një probabiliteti të moderuar dhe me shtrirje vetëm lokale.

- Ndikimet në faunë

Ndikimet kryesore në grupe të ndryshme të faunës nga ndërtimi, operimi dhe mirembajtja e projektit te propozuar mund të klasifikohen si shqetësim i lehte për elementet faunistik.

Ndërtimi përfshin pastrimin e vegjetacionit në vatra të pakta të gjetura, gërmimit të dheut, dhe lëvizja e mjeteve apo pajisjeve mbi rrugët dhe terren, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve dhe aktiviteteve të tjera mund të rezultojë në lëndime apo eliminimin e kafshëve.

Për pocionin e sheshit të ndertimit, ndikimet e tilla nuk mund të jenë të rëndësishme, pasi nuk përfshijnë një numër të madh të organizmash të cilat nuk janë të konsoliduara si komunitete apo popullata. Elementët faunistikë nuk karakterizohen nga ndjeshmeri e veçantë që të ndikohen në mënyrë specifike apo që të jenë të paaftë për të kompensuar humbjet në mënyrë të arsyeshme, ose janë tashmë të ulët në numër.

- Shpendet

Ndikimi mbi zogjtë në këtë mjedis gjatë ndërtim, operim, mirëmbajtje, mund të vlerësohet si i lehte dhe i rikthyeshëm.

- Ndikimet ne biodiversitet

Zona në shqyrtim zotëron kryesisht lloje të bimësisë se kultivuar në anë rruges dhe në lulishte e kënde të gjelberta. Sheshi i ndertimit të projektit nuk prek investime të kryera në këtë drejtim por vetem do të krijojë siperfaqe të gjelberta buzë rrugeve e koridoreve qarkulluese. Ndërtimi i kantierit të përkohshem me ambientin zyrë për ndjekjen e punimeve, pastrimin i tërrenit ku do të zhvillohet projekti i propozuar, hapja e koridoreve të përkohëshme qarkullimi tek fronti i punes, punime të tokës për themelet e shtresat e rruges,

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

transporti i materialeve, zhurma dhe vibracionet e krijuara nga aktivitetet e demolimeve dhe e ndërtimit, etj, përbëjnë burimet kryesore të ndikimeve në burimet ekologjike dhe të biodiversitetit në këtë zonë.

Ndikimet e mundshme mbi burimet ekologjike dhe biodiversitetin gjatë fazës së ndërtimit, operimit, mirëmbajtjes përfshijnë tjetërsimin e vendit si habitat i modifikuar nga njeriu e jo natyror, shqetësime të kafshëve (kryesisht shpëndëve) të mjedisit ose migrim i përkohshëm i atyre të zonës më larg sheshit të ndërtimit shkaktuar nga zhurma, dhe prania e njerëzve dhe mekanizmave, ndotjet nga pluhuri dhe emetimi i substancave të ndotura, rreziku i zjarrit në afërsi të shesheve të ndërtimit, çojnë në degradimin e kushteve të nevojshme që mbështesin biodiversitetin.

Në kushtet e habitateve artificiale dhe mungesë të specieve endemike, të rralla ose të rrezikuara ndikimi është i ulët.

3. Ndikimet në tokë

- Sipërfaqja e marrë në konsideratë:

Nga zhvillimi i projektit do të ketë një humbje të sipërfaqes së patrajtuar aktualisht nga ndertime infrastrukturore, objekte ndërtimore, nga punimet tokësore. Makinëritë e ndërtimit si dhe makinëritë e renda që bëjnë rregullimin e tokës mund të ndotin zonën me derdhjet e naftës, dhe mund ngjeshin ose të dëmtojnë tokën në zonën rreth objektit.

- Ndikimet e mundshme:

- Humbja e tokës së lirë nga zhvillimi i projektit;
- Ngjeshja e tokës nga mjetet qarkulluese në zonën rreth zones së projektit gjatë punimeve të ndërtimit;
- Ndotja e tokës, e cila mund të ndodhë me derdhjet e naftës nga transporti dhe mjeteve të punës ose përmes ujërave të zeza dhe mbetjet urbane nga sektori i punimeve gjatë aktiviteteve të ndërtimit.

Pasi janë zbatuar masat e duhura zbutëse, ndikimi i përgjithshëm mbi cilësinë e tokës mund të vlerësohen të një rëndësie të vogël dhe me masë të kufizuar.

4. Ndikimet në ajër

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

Vendi për zhvillimin e projektit ne zonen e Belshit, është zonë e mbuluar me bimësi të kultivuar apo natyrore dhe cilësia e ajrit përgjithësisht është në nivele shume te mira per zonat rurale. Zona ne studim nuk tejkalon standartin ditor të BE për PM10 si dhe PM 2.5, SO₂, NO₂ ndersa për CO ka tregues te rritur në krahasim me standartet kryesisht per shkak te rritjes se numrit të automjeteve qarkulluese në rrugët e aksesit.

Aktivitetet e ndërtimit dhe proceset e punes do të gjenerojnë pluhura dhe pezulli me grimca nga punimet e ndërtimit dhe transportit. Aktivitet që gjenerojne pluhura jane ndertimet e sektorit të punimeve, rregullime rrugore, pastrim bimësie, ngritja e kantierit dhe muret mbajtes si dhe emisionet e gazit nga mjetet e transportit dhe pajisjet e ndërtimit. Pluhuri, grimcat dhe emetimet e gazeve mund të ndikojë negativisht në biodiversitetin, burimet ujore dhe shëndetin e punëtorëve dhe të popullatës lokale. Shkarkimet ne ajer mund të specifikohen emetime të pluhurave dhe grimcave (pm₁₀). Emetimet me të medha pluhurave mund të ndodhin gjatë oreve të punës në aktivitetet ndertimore.

Pluhuri nuk shkakton ndryshime afatgjata në cilësinë e ajrit lokal, por depozitimi i tyre në mjediset në afërsi shkakton ndotje dhe për këtë arsye mund të rezultojë në ankesa, por që keto ndikime janë të përkohshme, ose gjatë fazës pregatitore dhe asaj të ndertimit.

Ndersa emetimet me grimcat pezull në atmosferë për një periudhë më të gjatë mund të transportohen më gjerë sesa pluhuri nëpërmjet eres, grimca të lëshuara edhe nga motorët të tilla si kompresorë, gjeneratorë, etj. Si madhësia e emisioneve PM10 është relativisht e vogël, çdo efekt anësore që rezultojnë prej tyre ka të ngjarë të jetë relativisht afatshkurtër pa efekte të rëndësishme jashtë kufijve të shesheve të ndërtimit.

Emetimet e gazeve: Ndotësit kryesorë në lidhje me të cilat janë të lidhur me trafikun rrugor gjatë zhvillimit te projektit janë NO₂, PM10, CO, benzen (C₆H₆) dhe benzopireni (C₂₀H₁₂). Emetimet e NO₂ dhe PM10 janë më shumë gjasa për të mos tejkalar standardet përkatëse të cilësisë së ajrit për vëndin tonë në objekt ne momente piku të punimeve si dhe nuk do te ndjehet ne zonën që është periferike ose ngjitur me kantjerin e ndertimit. Nuk parashikohet që keto ndikime të shtrihen dhe te jetë potenciale në cilësinë lokale të ajrit.

- Ndikimet ne peisazh

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

Gjatë fazës ndërtimit, operimit, mirëmbajtjes, do të ketë ndikime në vlerat e peizazhit rural dhe të pamjes në tëresi përmes ndryshimeve që do të ndodhin nga:

- Pastrimi i vegjetacionit të vendit ku do të ngrihet kantieri i rrugëve të mundshme hyrese të përkoheshme në anë të tij,
- Nga ndërtimi i sheshit të ndërtimit (ngritja e kantierit të punës)
- Nga qarkullimi i kamioneve të rëndë dhe nga prania e të gjithë aktivitetit ndërtimor.

5. Shkarkimi i mbetjeve

Shkarkimi i mbetjeve do të kryhet në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menazhimin e mbetjeve inerte".

Zotëuesi i mbetjeve inerte, i cili kryen përpunim paraprak, përzierje apo procese të tjera, që ndryshojnë natyrën ose përbërjen e këtyre mbetjeve, është i detyruar t'i ruajë, t'i transportojë dhe t'i dorëzojë ato në lëndfill apo në venddepozitim të përkohshëm në mënyrë të diferencuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme", si dhe vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

Zotëuesi i mbetjeve inerte është i detyruar t'i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta". Zotëuesit e mbetjeve inerte dhe operatorët e lëndfilleve të mbetjeve inerte janë të detyruar të plotësojnë dhe të nënshkruajnë dokumentin e transferimit të këtyre mbetjeve dhe të dhënat regjistrohen në Regjistrin e Transfertave Individuale, sipas vendimit

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

Subjekti fizik/juridik, që prodhon mbetje inerte gjatë ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes së objektit, është përgjegjës për dëmet e drejtpërdrejta ndaj palëve të treta që dëmtohen nga ushtrimi i aktivitetit të tyre dhe nga detyrimet kontraktuale.

Në vendin për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve inerte, të depozitohen jo më tepër se 20 tonë në ditë ose 3 500 tonë në vit mbetje inerte. Afati i dorëzimit të mbetjeve inerte në venddepozitimin e përkohshëm të jetë deri në momentin e ndërtimit të lëndfillit për trajtimin e mbetjeve inerte në zonën më të afërt gjeografikisht të njësisë së qeverisjes vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në venddepozitimin e përkohshëm ose lëndfilllet e trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për ton/mbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore.

Evadimi i dherave e mbetjeve te tjera te ndertimit

Shoqeria investitore me shpenzimet e veta do te kryje evadimin e dherave dhe mbetjeve te tjera te ndertimit qe do te dalin gjate hapjes se gropes se themeleve. Grumbullimi dhe transportimi i dherave do te behet konform kerkesave dhe rregullave mjedisore. Ato do te evadohen brenda dites, per te mos penguar punimet e metejshme e per te mos ndotur mjedisin.

Evadimi ne menyre te vazhdueshme i te gjitha mbeturinave qe do te krijohen gjate punes

Mbeturinat e ngurta, me natyre dhe perberje, do te jene mbeturina inerte te tilla si gure, leter, qelq, mbeturina llaçi tulle etj. Per grumbullimin e mbeturinave do te mbahen konteniere te veçante brenda rrethimit te objektit dhe me vone do te evadohen brenda dites per te mos penguar punimet e metejshme e ndotur mjedisin. Do te meren masa per lagien e mbeturinave ndertimore meqenese punimet kryhen ne nje nga zonat e banuara te qytetit.

Evadimi ne menyre te vazhdueshme dhe depozitimi i mbeturinave urbane

Evadimi ne menyre te vazhdueshme dhe depozitimi i mbeturinave urbane, qe do te kryhen gjate veprimtarise se ndertimit te **"Krijimi I Shtegur Turistik Liqeni I Deges - Liqeni I Merhojes- Kompleksi Eco Park"** dhe pas venies ne funksion te saj, do te kryhet ne vendin dhe ne kohen e caktuar qe do te miratohet dhe konfirmohet nga Njesia Administrative. Nuk

**Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'**

do te krijohen ndotje nga mbeturinat urbane per vete faktin se do te realizohet vendosja e konteniereve metalike per godinat e banimit dhe lokalet e sherbimit tregetar, te cilat do te kryejne aktivitetin e tyre te tregetimit dhe te sherbimeve te ndryshme.

Bazuar në VKM Nr.402 datë 30.06.2021 PËR MIRATIMIN E KATALOGUT TË MBETJEVE më poshtë po listojmë llojin e mbetjeve që gjenerohen nga ky ndërtim:

17 MBETJE NGA NDËRTIMET DHE PRISHJET (PËRFSHI DHERA TË GËRMUARA NGA ZONA TË KONTAMINUARA)

17 05 Dhera (duke përfshirë dhera të gërmuara nga toka të kontaminuara, gurë dhe balta të tjera)

17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03

17 05 06 Balta, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 05

17 05 08 Çakëll, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 07

Bazuar në LIGJIN Nr.9010, datë 13.2.2003 PËR ADMINISTRIMIN MJEDISOR TË MBETJEVE TË NGURTA, Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndërtimit

1. Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndërtimit bëhet me ripërdorim dhe groposje.
2. Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit miratojnë rregulloren e trajtimit të mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre.

Çështjet social ekonomike

Në lidhje me kontekstin lokal, zona e prekur do të jenë përfituese e drejtpërdrejtë nga aspekti ekonomik. Gjatë periudhës së ndërtimit dhe zhvillimit te projektit, do të ketë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve të ndërtimit që do të punësohen nga popullsia e zonës afër vendit ku zbatohet.

Përfitimet do të shkojnë për kompanitë lokale të ndërtimit të kontraktuar. Aktivitetet e ndërtimit ndikojnë e ofrojnë kushte të favorshme dhe inkurajojnë bizneset e reja, ose shërbimet për punëtorët e ndërtimit.

Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës

Faza e ndërtimit, operimit, mirëmbajtjes se projektit të propozuar do të favorizojë punësimin e një numri të konsiderueshem puntorësh në zonën që pritet fillimi i punimeve të

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

projektit. Punëdhënësi dhe të punësuarit do të jenë të detyruar të ndjekin përcaktimet e përfshira në aktet e ndryshme ligjore në fushën e punës dhe legjislacionit për mbrojtjen sociale. Masat duhet të jenë të përshkruara në drejtim të mbrojtjes së të punësuarve. Këto masa përfshijnë ndërmarrjen e detyrave të caktuara nga ana e personelit të kualifikuar, dispozitat për pajisje të përshtatshme personale të mbrojtjes, shmangien e aktiviteteve gjatë kushteve të keqesuara të motit, për ofrimin e shërbimeve sanitare dhe pajisje të mirëqenies në vend, si dhe identifikimin e duhur të rrezikut dhe vlerësimit të tij. Këto masa, së bashku me angazhimin në përputhje me ligjet e shëndetit dhe sigurisë shqiptare do të sigurojnë themelin mbi të cilin do të bazohet shëndeti dhe siguria e punonjësve.

Kushtet e punës dhe kompetencat e punës do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar të punës. Mjedisi i qëndrimit dhe i punës për punëtorët do të jetë i përshtatshëm, i pastër, i sigurt, për të siguruar nevojat bazë të punonjësve.

Kompania zbatuese e projektit do të jetë përgjegjëse për Shëndetin dhe Planin e Sigurisë për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të punës. Investitori do të shqyrtojë dhe të miratojë këto plane dhe do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e performancës së zbatuesit. Të gjithë punëtorët do të trajnohen në lidhje me rregullat dhe procedurat e duhura të sigurisë.

Ndikimi në komunitet, Shëndeti dhe Siguria

Aktivitetet e ndërtimit do të sjellin ndryshime të kufizuara në mënyrën e jetës së banorëve të zonës përreth zhvillimit të projektit. Lëvizja dikur e lirë dhe e pakufizuar të njerëzve në hyrje daljet e segmentit rrugor që do të ndertohet, në një pjesë të mjediseve të sheshit mund të bëhet me e kufizuar për shkak të pranisë së kamionëve dhe makinerive.

Është e rëndësishme që komuniteti të njohe e të jetë i informuar në lidhje me vendin e zbatimit të projektit për arsye të lëvizjeve të paautorizuara që mund të ndodhin në vendet e ndërtimit nga fëmijët dhe të rriturit e që mund të shkaktojnë pasoja të rënda për këta individë. Rrethimi i sheshit të ndërtimit dhe mbajtja nën kontroll, rrit masat e sigurisë në këtë drejtim. Zbatuesi i punimeve do të jetë i detyruar për të zhvilluar dhe zbatuar procedurat për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e publikut. Kjo do të përfshijë trajnime për punëtorët

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

dhe personelin e sigurisë për të parandaluar qasje të paautorizuara në vendet e ndërtimit, zonat e qarkullimit të mjeteve të ndërtimit, si dhe zonat e magazinimit të pajisjeve.

Çështjet e mundshme të shëndetit publik nga sëmundjet e ndryshme nga speciet vektoriale, nuk ka propabilitet të vlerësuar e të jetë i ndikueshem gjatë zbatimit të projektit.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Gjatë fazës operacionale, projekt nuk ka ndikime të cilat mund të konsiderohet si një rrezik shëndetësor të komunitetit. Gjatë fazës operacionale te rruges nuk do te kemi ndikime ne mjedis. Në këtë aspekt projekti i propozuar nuk do të krijojë kushte mjedisore të cilat mund të çojnë në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore në zonën e projektit, por do të ndikojë në rritjen e mundësisë së levizjes me te shpejte ne rrugen e rikonstruktuar, të cilësisë së kushteve të banimit, të rritjes së aktiviteve të shërbimit etj.

Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara.

Programi per kohezgjatjen e ndertimit dhe kohen e funksionimit te projektit

1. Analize e përmbledhur e kohezgjatjes se ndikimet negative ne mjedis

Aktivitetet që do të japin ndikime të mundshme negativisht në mjedis vetem gjatë të fazes së ndertimit të projektit (jo gjate fazes se operimit dhe mirembajtjes) ku përfshihet ajo parapregatitore e terrenit dhe të ndertimit të segmentit rrugor te propozuar lidhen me veprimtarite si vijon:

- Sistemimi i sheshit te ndertimit, gërmimet e tokës dhe demolimet per pastrimin e sheshit;
- Ndertimi i zyrave te perkohshme për mbikqyresit e zbatuesin e punimeve, percaktimi i vendqendrimit te mjeteve;
- Hapja e trasese se re, ndertimi i l shtresave te nevojshme te rruges;
- Percaktimi i rrugeve e koridoreve të qarkullimit në sheshin e ndertimit.
- Ndertimi i segmentit rrugor.

Ndikime të përherëshme mjedisore dhe sociale gjatë fazes se operimit dhe mirembajtjes se rruges, ku përfshihen edhe aktivitetet e mirëmbajtjes janë:

- Marrja e përhereshme e tokës për ndertimin e segmentit rrugor (shpronesimet);
- Ndryshimi ne peisazhin e zones se zhvillimit te projektit;
- Rritja e prezences se automjeteve nga hyrjet e daljet ne rruge;

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve në biodiversitet

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

Ndikimet e mundshme mbi burimet ekologjike dhe biodiversitetin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë tjetërsimin e vendit si habitat artificial urban, shqetesimi grupeve të kafshëve ose migrimi i përkohshëm i atyre në zonës në afersi shkaktuar nga zhurma, dhe prania e njerëzve dhe makinerive.

Po kështu ndotjet nga pluhuri dhe emetimi i substancave të ndotura, rreziku i zjarrit në afërsi të shesheve të ndërtimit, çojnë në degradimin e kushteve të nevojshme për të mbështetur biodiversitetin rural. Ndikimet negative në biodiversitet gjatë fazës së ndërtimit do të jetë i mjaft kufizuar dhe rezultojnë në një rëndësie të pothuajse të papërfillshme, me zbatimin e masave dhe procedurave të duhura parandaluese.

Gjatë fazes së operimit dhe mirembajtjes së rrugës nuk do të ketë ndikime në biodiversitet.

Analizë për kohëzgjatjen e ndikimeve në ujërat nëntoksore

Ndikimet e mundshme që do të zgjasin vetëm gjatë fazës ndërtimore janë:

- Punimet e ndërtimit, hapja e kanaleve kulluese të rrugës dhe vepra të tjera të lidhura me tokën;
- Aktivizimi i makinerive në ndërtim dhe transport, të cilat mund të sjellin rrezikun e ndotjes nga karburanti dhe vaji.

Ndikimet e mundshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme janë të përkohshme dhe do të zbuten duke aplikuar praktikën më të mirë për zbutjen nga këto lloje të mbeturinave.

Gjatë fazes së operimit dhe mirembajtjes së rrugës nuk do të ketë ndikime në ujërat nëntoksore pasi do të jetë vetëm kalimi i mjeteve në rrugë e nuk do të ketë hapje gropash apo kanalesh pasi këto të gjitha do të sistemohen gjatë fazës së ndërtimit.

Analizë për kohëzgjatjen e ndikimeve mbi ujërat sipërfaqësore

Ndikimet e mundshme mbi rrjedhat e ujit të lidhura me fazën parandërtimore dhe veprimtaritë e ndërtimit të ndryshme (ndërtimi i rrugëve hyrëse eventuale, punime tokësore dhe të kullimit; makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit; strukturat mbajtëse, shtresave të rrugës, etj), përfshijnë: Ndikimet e mundshme negative në ujërat

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

sipërfaqësoretë cilat janë vlerësuar të jenë të ulët, të njëprobabiliteti të ulët dhe me shtrirje vetëm lokale.

Gjate fazes se operimit dhe mirembajtjes se rruges nuk do te kete ndikime ne ujerat siperfaqshore pasi do te jete vetem kalimi I mjeteve ne rruge e nuk do te kete hapje gropash apo kanalesh pasi keto te gjitha do te sistemohen gjate fazes se ndertimit.

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve në tokë

Makinëritë e ndertimit si dhe makinëritë e renda që bejnë mbathjen e tokës mund të ndotin zonën me derdhjet e naftës, dhe mund ngjeshin ose të dëmtojë tokën në afersi të ndertimit te projektit.

Ky ndikim pavarësisht nga kohezgjatja, efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar e probabilitet të ulët e me shtrirje lokale duke mos marrë parasysh tjetërsimin e përdormit të saj.

Nuk ka ndikim të pritshëm në përdorimin e tokës gjatë fazës së operimit dhe mirëmbajtjes.

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve në ajër

Aktivitetet e ndërtimit do të gjenerojë pluhura dhe pezulli me grimca nga punimet e ndërtimit dhe transportit. Aktivitet që gjenerojne pluhura jane ndertimet e sektorit te punës, rregullime rrugore, pastrime e demolime për formimin e sheshit të ndertimit, ndërtimi i segmentit rrugor.

Shkarkimet ne ajer mund të specifikohen emetime të pluhurave dhe grimcave (pm₁₀). Emetimet me të medha pluhurave mund të ndodhin gjatë oreve të punës në aktivitetet e germimeve e ato ndertimore. Pluhuri nuk shkakton ndryshime të gjata ose të gjera afatgjata në cilësinë e ajrit lokal, por depozitimi i tyre në objektet e afërta shkakton ndotje dhe për këtë arsye mund të rezultojë në ankesa por që keto ndikime janë të përkohshme, ose gjatë fazës pregatitore dhe asaj të ndertimit.

Ndersa emetimet me grimcat pezull në atmosferë për një periudhë më të gjatë dhe që mund të transportohen më gjerë sesa pluhuri, nëpërmjet eres, grimca të lëshuara edhe nga motorët të tilla si kompresorë, gjeneratorë, etj. Si madhësia e emisioneve PM10 është relativisht i

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

vogël, çdo efekte anësore që rezultojnë prej tyre ka të ngjarë të jetë relativisht afatshkurtër pa efekte të rëndësishme jashtë kufijve të shesheve të ndërtimit.

Ndërsa gjatë fazës së operimit dhe mirëmbajtjes, ndikimi mund të zbutet duke marrë masat e duhura, të ngjashme me fazën e ndërtimit.

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve të mundshme nga zhurmat dhe vibrimet

Zhurma dhe dridhjet do të gjenerohet kryesisht nga aktivitetet e ndërtimit dhe mjeteve të transportit, të cilat do të jenë në përgjithësi kamionë të rëndë dhe makineri të ndryshme si fadromat, vinça, etj.

Reagimi i njerëzve për të vibracioneve në terren është e ndikuar nga shumë faktorë fizike ku përfshihet dhe kohezgjatja. Është pranuar përgjithësisht se për shumicën e njerëzve, nivelet dridhjeve ndërmjet 0.15 dhe 0.3 mm/s janë vetëm perceptueshme. Për shkak të faktit se ka prona banimi në afërsi të ndërtimit të segmentit rrugor, ka gjasa që vibrimet nga ndërtimi i rrugës të propozuar të jetë të evidentueshme.

Analize për kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme në peisazh dhe vizualiteti

Ndikimi në peisazhin e kësaj zone është i dukshëm por duke pasqyruar se në po të njëjten gjurmë të projektit kemi rrugën ekzistuese, perceptimi në ndryshim peisazhi është jo shumë potencial dhe i ambientueshëm me pamjen.

Analize për kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme nga gjenerimi i mbetjeve

Në fazën ndërtimore, burimi kryesor i mbetjeve do të jetë aktiviteti ndërtimor, dhe mbetjet e krijuara nga punëtorët. Duke qenë se shumica e aktiviteteve të ndërtimit rezultojnë me mbetje të kufizuara e jo të rëndësishme, sidomos nga përdorimi i elementeve ndërtimor. Fraksionet e mbetjeve që do të krijohen si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit janë në lidhje me llojet e materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren gjatë kryerjes së fazave të ndërtimit.

5. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësirë të ndikimeve negative në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.

1. Distancën fizike nga vendndodhja e projektit

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

Bazuar në karakteristikat dhe elementet e projektit, distanca e ndikimit në mjedis mund të shtrihet vetëm në një zonë periferike të kufizuar nga objekte e banimi, por përgjithësisht nuk mund të jetë jashtë hapësirës së territorit ku shtrihet ndertimi i objektit veçanërisht gjatë fazës së operimit. Ndërsa të vetmet burime të vibrimit që merret në konsideratë do të jenë kamionë të rëndë gjatë udhëtimit për në objekt.

Për aktivitetet e ndërtimit distance nga ku mund të perceptohet vibrimi është si vijon:

Punimet gërmuese të tokës deri 10 -15 m largësi.

Kompaktimi dhe ngjeshja me vibrim 10 – 15 m largësi.

Levizja e kamioneve të rëndë, 5 deri 10 m.

6. Mundësia e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e përafërta për rehabilitimin.

1. **Mundësia e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme**

Rehabilitimi mjedisit të ndikuar është akti i restaurimit të mjedisit për ta kthyer atë në gjendjen origjinale, para ndikimeve në këtë rast nga zbatimi i projektit. Nëpërmjet rehabilitimit synohet mbrojtja e cilësive natyrore të trashëguara të mjedisit, mbrojtja e shëndetit të punonjësve, mbrojtja e cilësisë së ujërave nëntoksore e sipërfaqësore, mbrojtja së cilësisë së tokës, ajrit, garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm në harmoni me mjedisin.

Kthimi i mjedisit në gjendje të mëparshme është një proces që përfshin zbatim masash e veprimesh që bëjnë përgatitjen e sistemit të terrenit të ndikuar, për parandalimin e erozionit, të ngjeshjes së metejshme të tokës, për gjelbërimin e rigjëlërimin, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në mënyrë të vazhdueshme që garanton shëndetin e mjedisit.

Masat rehabilituese të përcaktuara në planin të rehabilitimit zbatohen duke kryer punime që adresojnë kërkesat teknike si dhe ato estetike e ekologjike.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

Sistemimi i sheshi të ndertimit të projektit është ngushtësisht i varur nga kërkesat teknike inxhenerike të ketij projekti, distancat e sigurisë, efektiviteti i perdorimit racional të tokës në vartësi të parametrave teknik të projektit. Nderhyrjet rehabilituese brenda sheshit lidhen ngushte me respektimin e kushteve teknike inxhinierike të projektit. Shtresezimet e sipërfaqeve te sheshit midis elementeve ndertimor të projektit, koridoret qarkulluese e te sherbimeve te mirembajtjes respektojnë rigorozisht kushtet teknike.

Zona periferike jashtë sheshit është sipërfaqe e zhvilluar me objekte banimi, rruge e trotuare dhe duhet të restaurohet në rastin e ndikimeve të paevitueshme duke ju referuar praktikave më mira restauruese e rehabilituese në tëresi që risjellin e promovojnë vlerat e peisazhit si dhe cilësitë e kësaj zone rurale. Në këtë mënyrë ndikohen në rritje të cilësisë mjedisore dhe në përmirsimin e cilësisë së ajrit, mbrojtjen nga erozioni etj.

Mundesimi i gjelberimit ne te gjithe gjurmen e ndertimit te rruges nga projekti më të gjitha menyrat që lëjon një mjedis i tillë rural duhet të bëhet për të plotësim sa më maksimalisht kërkesat përmirsuese e restauruse estetike dhe ekologjiikë.

Llojet bimor që përdoren për rritjen e vlerave estetike mjedisore janë në vartesi të volumit të kurores vegjetative të llojit, anës dekorative që prezanton si dhe dendesise së përdorimit të llojit.

2. Sistemimi i terrenit të ndikuar dhe përgatitja e vendit

Nderhyrja e parë që behet për rehabilitimin e vendit është sistemimi i tij, dhe sigurimi e ruajtja e vendit nga mosdemtimi, gjatë punimev rehabilituese.

Masat e sugjeruara

Punimet e pastrimit e sistemimit të vendit pas përfundimit të ndertimit të segmentit rrugor përfshijnë:

- Largimi i të gjitha pajisjeve e mjeteve që kanë sherbyer gjatë procesit ndertimor e instalimeve në kantierin e punimeve.
- Largimi dhe administrimi i përshtatshëm i të gjitha mbetjeve inerte nga teritori që rehabilitohet dhe çdo lloje mbetje tjetër në qofte se nuk është trajtuar apo neglizhuar.
- Ndalimi i çdo veprimtarie që ka të beje më direkt ose indirekt me aktivitet ndertimor.
- Marrja e masave në pengimin e qarkullimit të lirë të njerezve e kafshëve deri në rahabilitimin e plotë të zonës.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

3. Mbjellja e bimësisë

Përdorimi i bimësisë si pjesë e projektit është ndikimi më potencial në krijimin e një ekulibri të stabilizuar me funksion të shumfishtë ripërtritës e me ndikime direkte në përmirsimin e treguesve mjedisor. Ndikim të rëndësishëm ka në përmirsimin e vlerave pejsazhiste, duke përmirësuar aspektin pamor.

4. Masat e sugjeruara

- Përdorimi i bimeve dekorative që të përshtatet me kërkesat estetike dhe që garanton suksesin e përmirimit të pejsazhit i zones se zhvillimit te projektit.
- Përdorimi i nje shtrese me material të tillë që të ndaloje mbirjen e barerave të këqija rreth fidaneve, ruajtjen e për ruajtjen e lageshtirës.

5. Mbjellja e fidaneve

Mbjellja behet me anë të fidaneve të prodhuar ne fidanishte të llojeve dekorative. Skemat e mbjelljes të llojeve behen duke respektuar dendesinë lejuar si dhe kombinimet e llojeve.

6. Mirëmbajtja

Punimet për mirëmbajtjen lidhen me shërbimet që kërkojnë rritja e bimesisë për plotësimin e kërkesave për ujë, element ushqyes, krasitje, pastrim etj. Në mënyrë të veçantë do të bëhet menjëherë zëvendësimi i fidaneve që rezultojnë të deshtuara në mbirje ose që zhvillohen të dobët në krahasim me pjesën tjetër. Kjo gjë do te behet gjate fazes se operimit dhe mirembajtjes se segmentit rrugor qe do te ndertohtet.

7. Monitorimi

Monitorimi lidhet me të gjithë aspektet e mbarvajtjes së nderhyrjeve rehabilituese për të garantuar suksesin e saj. Inspektimet e vazhdueshëm në lidhje me zenien e fidaneve e të gjendjes se vegjetacionin në tëresi do të shërbejnë për marrjen e masave te menjehershme të vijueshmërisë së sukseseshme të rehabilitimit.

8. Monitorimi mjedisor

Programi i monitorimit mjedisor është i nderfutur në projekt dhe përfshin inspektime dhe raportime zone rutinë.

- Monitorimi i tokës dhe erozionit

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

Gjatë ndërtimit, eksperti mjedisor do të inspektojë të gjitha punimet javore, për t'u siguruar që masat për erozionin e tokës janë implementuar siç duhet. Nëse kërkesat nuk janë zbatuar, ai do të njoftojë menjëherë kontraktuesin dhe supervizori duhet të jetë i përgjegjshëm që të merren masat e duhura dhe korrekte. Gjatë operimit, eksperti mjedisor do të inspektojë korsitë e rrugës katër herë në vit, në mënyrë që të përcaktojë nëse ndonjë zonë është në mënyrë të veçantë e prekshme nga erozioni i tokës, apo nëse ky erozion po ndodh. Në rast se ai gjen shenja erozioni aktuale ose potenciale, ai duhet të njoftojë menjëherë përgjegjësit e Agjencise Rajonale te Mjedisit.

- Monitorimi i cilësisë së ujit

Monitorimi para ndërtimit, për të vendosur kushtet fillestare, duhet bërë në zonat që ka vendosur supervizori. Monitorimi fillestar i cilësisë së ujit rekomandohet në zonat me burimet më të mëdha të ndotjes potenciale të ujit (kampet e ndërtimit dhe burime të tjera të rrjedhjeve të rëndësishme dhe prodhimit të ndotjeve të lëngeta). Rekomandohet matja e grimcave në suspensë [MES], kërkesës biologjike për oksigjen [BOD], konduktiviteti dhe koliformët fekale dhe nivelet e vajit dhe grasos. Frekuenca e monitorimit të cilësisë së ujit do të vendoset nga supervizori gjatë periudhës së ndërtimit, zbatohet nga Pushteti vendor dhe sipërmarrjet publike gjatë funksionimit të rrugës.

Duhet të bëjmë matjet e niveleve të:

- materies në suspensë [MES]
- kërkesës biologjike për oksigjen [BOD]
- oksigjeni i tretur [DO]
- konduktivitetit
- koliformëve fekale
- vajit dhe yndyrnave

- Monitorimi rutinë dhe periodik i zhurmave

Kontratat e ndërtimit duhet të specifikojnë se monitorimi i zhurmave me aparatura për një periudhë të caktuar, përpara fillimit të ndërtimeve, duhet të vendosen kushtet kryesore për impaktet që mund të identifikohen. Monitorimi shtesë me aparatura i zhurmave dhe vibrimeve nuk konsiderohet i justifikuar në kushtet ekzistuese të mjedisit (psh.nivelet ekzistuese të vibrimit në hapësirat me prezence banesash janë në thelb gati zero).

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

Do të specifikohen masat e sigurisë për monitorimin shtesë të cilësisë së ujit me kërkesë të supervisorit, nëse ndeshemi me rrethana të paparashikuara. Monitorimi i niveleve të zhurmave me aparatura duhet të përcaktohet në jo më pak se dy zona të rehabilitimit të rrugës, në të njëjtat zona ku është bërë monitorimi i kushteve fillestare.

Monitorimi i niveleve të zhurmave do të përsëritet jo më pak se një herë në muaj në çdo zonë dhe ndoshta më shpesh nqs e kërkon konsulenti i supervizimit. Një masë tjetër për monitorimin e zhurmave është se kontrata duhet të specifikojë burimet e kontrollit, kohën gjatë ditës kur nuk duhet të punohet dhe aktivitetet për informimin e komunitetit.

- Monitorimi rutinë dhe periodik i cilësisë së ajrit

Kontratat e ndërtimit duhet të specifikojnë një monitorim me aparatura për një periudhë kohore një mujore, përpara se të fillojë ndërtimi të vendosen drejtimet bazë, ku të specifikohen impaktet që do të maten.

Zonat kryesore të monitorimit do të vendosen në bazë të planeve aktuale të ndërtimit, duke përfshirë zonat specifike që janë burime ndotjeje (psh. impiantet e betonit, impiantet e thyerjes se gurit) dhe duke u mbikqyrur në mënyrë korrekte nga supervisor. Monitorimin shtesë me aparatura për ndotësit e ajrit, përveç pluhurave, nuk e konsiderojmë të drejtë, për shkak të kushteve ekzistuese të ambjentit. Në rast se supervisor do të kërkojë monitorim shtesë me aparatura, kur ndeshemi me rrethana të paparashikuara, atëhere këto aparatura do të përfshihen.

Aparatura të specializuara monitorimi do të përcaktohen në çdo zonë monitorimi që në fillim të ndërtimit. Monitorimi i cilësisë së ajrit do të përsëritet jo më pak se një herë në muaj në çdo zonë dhe ndoshta më shpesh nqs e kërkon konsulenti i supervizimit. Do të specifikohen edhe masat e sigurisë për monitorimin shtesë të cilësisë së ajrit me kërkesë të supervisorit, nëse ndeshemi me rrethana të paparashikuara.

- Mbetjet dhe masa të tjera sigurie

Kontraktuesit duhet t'i kërkohet të sistemojë mbetjet konform legjislacionit ne fuqi , ku ne bashkepunim me Pushtetin Vendor percakton vendin e depozitimit te mbetjeve te ngurta te cilat do te prodhohen gjate ndertimit te rrugëve. Mbetjet përfshijnë ujrat e përdorura (të

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

papastra) dhe mbetjet solide, mbetjet e lubrifikantëve dhe mbetjet nga ndërtimet. Kontraktuesi duhet të përgatiti një plan për sistemimin e mbetjeve, i cili duhet të aprovohet nga supervizori dhe Pushteti vendor. Në mbarim të punës kontraktuesi duhet të heqë dhe të pastrojë të gjitha kampet e punës në përputhje me ruajtjen e kushteve mjedisore. Kontrata duhet të përmbajë masa për rrugët e tërthorta dhe ndërprerjen e trafikut, prishje procedimi (nëse ka ndonjë) dhe procedura përgjigjeje urgjente në rast aksidentesh dhe katastrofash natyrore. Kontrata duhet të përmbajë masa për ndalimin e punimeve dhe njoftimin e konsulentit të supervizimit në rast gjetjeje relikesh kulturore ose arkeologjike.

- Siguria e rrugës

Konsulenti i specializuar do të ndërmarrë një program revizionues për sigurinë e rrugës duke kryer inspektimin e projektit dhe dokumentave të tenderimit. Kjo do të specifikojë masat mbrojtëse të projektit, sinjalistikën vertikale dhe horizontale, parmakët mbrojtës dhe masa të tjera të nevojshme për sigurinë maksimale të rrugës. Këto masa do të përfshihen në planimetritë e kontratës dhe me shpjegimin e duhur teknik. Revizionime të tjera të sigurisë së rrugës do të ndërmerren gjatë ndërtimit dhe operimit.

- Raportimi

Zbatuesi i punimeve ne bashkepunim me Pushtetin Vendor duhet të përgatise një raport vjetor duke detajuar rezultatet e programit monitorues.

- Forcimi institucional

Në mënyrë që të jemi në gjendje të ndërmarrim një monitorim kompetent (të përshtatshëm) të projektit të ndërtimit te segmentit rrugor, zbatuesi i punimeve ne bashkepunim me Pushtetin vendor duhet të emërojë një specialist mjedisi i cili do të jetë përgjegjës për Monitorimin e mjedisit gjate periudhes se punimeve. Ky nënpunës do të rekrutohet ndërmjet ekspertit lokal të kualifikuar. Këtyre ekspertëve do t'u bëhet trajnim shtesë nëpërmjet kontratave sipas ligjeve në fuqi.

- Studimi arkeologjik

Një studim i detajuar arkeologjik , do të ndërmerret në paralel me projektin final dhe çdo relike arkeologjike e gjetur do të lëvizet dhe konservohet përpara fillimit të ndërtimeve. Në rastet kur lokalizohet një zbulim i rëndësishëm, siç janë reliket e mureve ose ndonjë lloj tjetër, puna duhet të ndalohet menjëherë dhe kontraktori duhet të njoftojë menaxherin e

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

projektit dhe punëdhënësin, të cilët duhet t'i kushtojnë vëmendje maksimale në identifikimin dhe në konservimin e objekteve me vlerë.

9. PROGRAMI I MONITORIMIT TE MJEDISIT

Qëllimi i programit:

Të sigurojë që gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të projektit të monitorohen të gjithë komponentët mjedisorë të ndjeshëm ndaj ndikimeve, për të garantuar përputhshmërinë me legjislacionin mjedisor shqiptar dhe masat e përcaktuara në Planin e Menaxhimit Mjedisor (PMM).

9.1. Objektivat e Monitorimit

- Verifikimi i zbatimit të masave mbrojtëse dhe lehtësuese.
- Identifikimi në kohë i çdo devijimi apo ndotjeje potenciale.

Sigurimi i ruajtjes së cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit. Mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së komunitetit dhe punëtorëve.

9.2. Komponentët dhe treguesit e monitorimit

NR	KOMPONENTI	TREGUESIT E MONITORIMIT	FAZA	FREKUENCA	METODA	PËRGJEGJËS
1	Cilësia e ajrit dhe pluhuri	Koncentrimi i pluhurit (PM ₁₀ , PM _{2.5}) në afërsi të kantierit dhe banesave pranë rrugës	Ndërtim	1 herë/muaj gjatë punimeve intensive	Matje me pajisje portative ose inspektim vizual	Kontraktori / Njësia Mjedisore Bashkiake
2	Zhurma	Nivelet e zhurmës (dB) pranë zonave të ndjeshme (shkolla, banesa)	Ndërtim	1 herë/muaj ose në ankesa nga komuniteti	Pajisje matëse decibelmetër	Kontraktori / Inspektori Mjedisor
3	Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	Cilësia e ujit (pH, TSS, BOD, COD, vajra) në burime pranë kantierit	Ndërtim / Operim	Para nisjes dhe çdo 3 muaj gjatë punimeve	Mostrime laboratorike	Kontraktori / Laborator i licencuar
4	Toka dhe mbetjet	Sasia e mbetjeve inerte, mënyra e depozitimit	Ndërtim	Gjatë gjithë periudhës së punimeve	Kontroll vizual dhe regjistër	Kontraktori / Bashkia

Raporti Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

5	Vegetacioni dhe faunë	Dëmtime të mundshme të gjelbërimit, prerje jashtë zonës së lejuar	Ndërtim	Periodikisht	Inspektim vizual në terren	Specialist Mjedis
6	Siguria në punë dhe shëndeti	Zbatimi i masave të sigurisë, përdorimi i PPE	Ndërtim	Javore	Kontroll vizual dhe raportim	Kontraktori / Koordinator i Sigurisë
7	Ndikimi social	Ankesa nga komuniteti, dëmtime të pronave	Ndërtim / Operim	Sipas nevojës	Regjistër ankesash	Bashkia / Kontraktori

9.3. Raportimi

- Raporte mujore dhe 3 mujore të monitorimit gjatë fazës së ndërtimit
- Raporte përmbledhëse në përfundim të fazës së punimeve
- Raportet i dorëzohen:
 - Autoritetit Kontraktues
 - Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM)
 - Bashkisë Belsh

9.4. Masat Korrigjuese

Në rast devijimi nga standardet:

- Ndalim i përkohshëm i punimeve në zonën problematike.
- Pastrimi i zonës dhe rehabilitimi.
- Rritja e frekuencës së spërkatjes për pluhurin.
- Vendosja e barrierave akustike në rast tejkalimi të zhurmës.
- Njoftimi i menjëhershëm i autoriteteve mjedisore.

9.5. Dokumentacioni i Monitorimit

- Formularë ditore për kontrollin e masave mjedisore.
- Regjistër i mbetjeve dhe transportuesve të licencuar.
- Raporte matjesh dhe analizash laboratorike (nga laboratore të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit).
- Regjistër ankesash nga komuniteti.

10. Plani i menaxhimit mjedisor

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

10.1. Qëllimi i Planit

Ky plan synon të:

- Sigurojë zbatimin e masave parandaluese, mbrojtëse dhe lehtësuese për ndikimet mjedisore që mund të shkaktojë projekti.
- Përcaktojë përgjegjësitë dhe procedurat për menaxhimin e komponentëve mjedisorë gjatë fazave të ndërtimit dhe shfrytëzimit.
- Sigurojë përputhjen me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e mjedisit.

10.2. Fushëveprimi

Plani mbulon të gjitha fazat e projektit:

- Para ndërtimit (përgatitja e kantierit, pastrimi i terrenit)
- Gjatë ndërtimit (rikonstruksioni te rrugëve)
- Pas ndërtimit / Operimi (mirëmbajtja e rrugës dhe menaxhimi i ndikimeve afatgjata)

10.3. Korniza Ligjore

Zbatimi i këtij plani bazohet në:

- Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"
- Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"
- VKM Nr. 247, datë 30.04.2014 "Për miratimin e rregullores për VNM-në"
- Ligjin Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- Legjislacioni për mbrojtjen e ajrit, ujërave, zhurmës dhe biodiversitetit në fuqi.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

NR	KOMPONENTI MJEDISOR	NDIKIMET E MUNDSHME	MASA PARANDALUESE / LEHTËSUESE	FAZA	PËRGJEGJËS
1	Ajri dhe pluhuri	Ngritje pluhuri nga punimet, makineritë dhe transporti i materialeve	Spërkatje periodike e rrugës me ujë; mbulimi i ngarkesave; mirëmbajtja e mjeteve	Ndërtim	Kontraktori
2	Zhurma	Zhurme nga makineritë, kompresorët, transporti	Kufizim orari pune (07:00-19:00); përdorim pajisjesh me izolim akustik	Ndërtim	Kontraktori
3	Ujërat sipërfaqësore	Rrjedhje vaji/karburanti, sedimentim në kanale	Ndalohet pastrimi i mjeteve pranë burimeve ujore; depozitimi në zona të përcaktuara	Ndërtim	Kontraktori
4	Toka dhe peizazhi	Degradim nga depozitimi i materialeve inerte	Depozitim në vende të miratuara nga bashkia; rehabilitim i menjëhershëm pas punimeve	Ndërtim	Kontraktori
5	Vegetacioni dhe fauna	Dëmtime të gjelbërimit ose habitateve lokale	Kufizim i zonës së punimeve; ndalim prerjes jashtë gjurmës së projektit	Ndërtim	Kontraktori / Specialist Mjedis
6	Mbetjet inerte dhe urbane	Gjenerim inerte, mbeturina plastike dhe metalike	Riciklim i materialeve të përshtatshme; transport nga operatorë të licencuar	Ndërtim	Kontraktori / Bashkia
7	Aspektet sociale	Pengesa për banorët, pluhur, zhurmë	Njoftim paraprak i komunitetit; vendosje tabelash informuese dhe sinjalistikë	Ndërtim	Kontraktori / Bashkia
8	Siguria në punë	Rreziqe aksidentesh për punëtorët	Përdorim i PPE (helmetë, doreza, jelek reflektues); trajnime periodike	Ndërtim	Kontraktori
9	Faza e operimit	Ndikime nga mirëmbajtja (pluhur, mbetje)	Kontroll periodik i rrugës; pastrim i kanaleve kulluese	Operim	Bashkia / Ndërmarrja Rrugore

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim" Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

10.4. Raportimi dhe Auditimi

- Kontraktori duhet të përgatisë raporte mujore për zbatimin e masave mjedisore.
- Mbikëqyrësi i punimeve dhe Bashkia përgatisin raport përmbljedhës çdo 3 muaj.
- Auditimet mjedisore do të kryhen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ose struktura përkatëse lokale.

10.5. Masat në Rast Emergjence

Në rast derdhjeje karburanti, zjarrvënie apo ndotje të papritur:

- Ndalohej menjëherë puna në zonën e prekur.
- Njoftohet Bashkia dhe Agjencia e Mjedisit.
- Kryhet pastrimi dhe rehabilitimi sipas udhëzimeve teknike.
- Regjistrohet incidenti dhe merren masa korrigjuese për parandalim në të ardhmen.

10.6. Përgjegjësitë Institucionale

INSTITUCIONI / SUBJEKTI	PËRGJEGJËSITË KRYESORE
Kontraktori	Zbatimi i masave mjedisore, raportimi periodik, menaxhimi i mbetjeve
Mbikëqyrësi i punimeve	Kontrolli i zbatimit në terren, verifikimi i standardeve
Bashkia	Monitorim i përgjithshëm, menaxhim i mbetjeve, komunikim me komunitetin
AKM / ARM	Inspektime dhe auditim mjedisor, miratimi i raporteve
Komuniteti lokal	Raportim i çdo shqetësimi apo ankese mjedisore

10.7. Rehabilitimi pas punimeve

Pas përfundimit të punimeve, të gjitha zonat e prekura do të:

- Pastrohen nga mbetjet dhe materialet e mbetura;
- Rilërohen dhe mbillen me bar ose bimësi lokale;
- Rikthehet forma natyrore e terrenit dhe peizazhit.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: 'Studim projektim' Rikonstruksioni i rrugëve te Brendshme Fshati Shtermen'

11. Kostot financiare të përafërta për rehabilitimin

Masat kryesore për zbutjen e ndikimeve negative në të gjitha fazat e zbatimit të projektit janë të paraqitura në tabelen në vijim ku janë patrashtruar edhe kostot e përafërta financiare. Masat e identifikuara ju referohen praktikave më të mira rehabilituese si pjesë e planit të menaxhimit mjedisor në tërësi ku kostot e vleresuara përfshihen në kostot e zbatimit të projektit.

Veprimtaria	Efektet potenciale	Plani i minimizimit e zbutjes se ndikimit	Pergjegjesia
Pastrimi e pergatitja e vendit ku zbatohet projekti	Ngjeshje e demtimi i strukturese se tokes se zones ne afersi	Rrethimi i sheshit te ndertimit. Ndalimi i nderhyrjeve te panevojshme ne afersi. Krijimi i sektorit te punimeve brenda sheshit dhe spostimet e nevojshme sipas kerkesave teknike e zhvillimore te objektit. Vendosja e tabelave sinjalizuese	Zhvilluesi
Sistemimi i vendit te punes	Presioni ne sistemin drenazhues dhe erozionin e tokes	Berja e zbatimi i nje plani drenazhimi per mbrojtjen e tokes nga erozioni dhe evitimi i pellgjeve me uje.	Zhvilluesi
Hapjet e njesive te ndryshme te segmentit rrugor te projektit	Emetime ndotese ne ajer	Levizja e evadimet e dherave te behen ne kushtet e lagies per uljen e pluhura. Sperkatja e herepas-hershme e stoqeve, mbajtja e mjedisit paster.	Zhvilluesi
Punimet e ndertimit	Ndikimi me zhurmat e vibrimet	Pajisjet e ndertimit duhet te jene sipas Direktivave Standarteve te Komunitetit European 2000/14/EC, Maj. 2000 si edhe ne perputhje me legjislacionin mjedisor shqiptar. Te gjitha pajisjet duhet te mbahen ne kushte te mira.	Zhvilluesi
Largimi i mbetjeve nga pastrimi i terrenit	Ndotja e ajrit, Ndikim ne ndotjen e tokes Ndikimi ne shendetin e punonjesve	Caktimi, i vendit te administrimit e trajtimit te mbetjeve. Marrja e lejeve nga Njesia e Qeverisjes lokale per depozitimin e dherave. Sigurimi i paisjeve personale mbrojtese nga pluhurat. Evitimi i shpejtesive te panevojshme te automjeteve	Zhvilluesi
Punimet operatore ne zonen e projektit	Mungesa e vegjetacionit	Hartimi i nje projekti per gjelberimet e mundeshme. Mirembajtja	Studio projektuese Zhvilluesi
Punime operatore	Rreziku i demtimit te infrastruktures urbane	Mirembajtja e riparimi i menjehereshme sipas rastit.	Zhvilluesi

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: "Krijimi I Shtegur Turistik Liqeni I Deges – Liqeni I Merhojes- Kompleksi Eco Park"

7. Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis

1. Masat për mbrojtjen e argjinaturës dhe të pjerrësisë

Kontrata duhet të specifikojë që rigjëlberimi final duhet të kompletohet sa më shpejt të jetë e mundur, duke ndjekur vendosjen e mbushjeve, në mënyrë që të lehtësojë stabilizimin e mbulesës së tokës. Duhet të bëhen kanale ne largesi çdo 6 m, atje ku nevojitet për të siguruar një vegjetacion sa më të mirë.

Kontrata duhet të specifikojë që:

- a) Pjerrësia e argjinaturës së rrugës do të mbillet me bimësi që rritet shpejt dhe të bashkohet menjëherë me farë të bimëve natyrore të atij vendi. Kështu ndalohet erozioni dhe nxitet stabilizimi.
- b) Pjerrësia e argjinaturës dhe prerjet e rrugës do të stabilizohen me anë të rigjëlberimit, i cili do të bëhet me specie bimore, me anë të vendosjes së fibrave prej mushamaje, me anë të gurëve të thyer, gabionave prej guri, teknologji të tjera të përshtatshme.
- c) Zonat e shkarkimit të strukturave të drenazhimit do të pajisen me gurë të thyer për të evituar erozionin, veçanërisht në pjesët ku strukturat e drenazhimit janë instaluar në pjesët që nivelet e formacionit rrugor janë të ngritura dhe krijojnë pjerrësi të zhveshura, gje e cila do të kërkojë stabilizimin përpara sezonit të shirave.

2. Masat për kampet e ndërtimit dhe për objektet e ngjashme

Specifikimet në kontratën e projektit duhet të përcaktojnë që restaurimi i objekteve, të cilat strehojnë personelin e ndërtimit, ruajtjen e pajisjeve dhe mjeteve, kampet e punës dhe objekte të ngjashme, duhet të drejtohen dhe të aprovohen nga supervizori. Kjo aplikohet tek të gjitha objektet e këtij lloji duke përfshirë edhe ato private. Të gjitha pajisjet e ndërtimit duhet të liçensohen sipas kërkesave lokale.

3. Masat zbutese per ndikimet ne biodiversitet

Masat zbutese per ndikimet ne biodiversitet perfshijne:

- o Masat të ndryshme zbutëse do të jenë të nevojshme në sheshin e ndërtimit në minimizimin e ndikimeve në biodiversitetin e zones se projektit.
- o Punimet e pastrimit të vendit e të përgatitjes së shtresave te rruges të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:

Objekti: "Krijimi I Shtegur Turistik Liqeni I Deges – Liqeni I Merhojes- Kompleksi Eco Park"

- Evitimi i hyrjeve të tjera në sheshin e ndertimit dhe përdorimi sa më shumë që të jetë e mundur i rrugët ekzistuese të aksesit dhe të minimizimi i hyrjeve të reja.
- Limitimi i shtrirjes së aktivitetit ndertimor do të mbeshtesë e do të evitojë shqetësimet në faunën e zones.
- Administrimi i mbeturinave në mënyre të përshtatshme sipa Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.
- Mënjeherë pas përfundimit, të restaurohen vatrat e degraduara si rezultat i aktivitetit ndertimor.
- Ndikimet negative në biodiversitet gjatë fazës së ndërtimit do të jetë i kufizuar dhe rezultojnë në një rëndësi të pothuajse të papërfillshme, me zbatimin e masave dhe procedurave të duhura parandaluese.

4. Masat zbutese për ndikimet në ujërat nëntoksore

Është e nevojshme marrja e masave të përgjithshme të praktikës së mirë ndërtimit për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme të shkarkimeve në ujërat nëntokësore, gjatë përgatitjes dhe fazat e ndërtimit. Shmangia sa më shumë që të jetë e mundur zonat ku ka sisteme furnizimi me ujë. Nëse merren këto masa zbutëse, ndikimet e mundshme mund të reduktohet në një probabilitet të papërfillshëm dhe të rëndësisë vetëm lokale.

Ndikimet e përkohshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme duhet të zbutet duke aplikuar praktikën më të mirë për zbutjen nga këto lloje të mbeturinave.

5. Masat zbutese për ndikimet në Ujërat sipërfaqësore

Është e nevojshme zbatimi i një sërë masash të përgjithshme të praktikës së mirë të ndërtimit për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme të shkarkimeve në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së ndërtimit të segmentit rugor. Duhet të merren masa zbutëse që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga ujërat e zeza dhe nga mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme qëndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore mund të reduktohet në një rëndësi të papërfillshme, dhe në masë lokale.

Nuk janë parashikuar ndikime të rëndësishme në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së ndërtimit, për zonën e projektit. Ndikimet e përkohshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme janë vlerësuar nga probabilitet e madhësi të ulët me shtrirje lokale. Ato mund të zbutet duke zbatuar praktikën e duhur për këto lloje të mbeturinave. Pasi zbatohen këto masa zbutëse, ndikimi i pritshëm mund të vlerësohet si i parëndësishëm.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: "Krijimi i Shtegur Turistik Liqeni i Deges – Liqeni i Merhojes- Kompleksi Eco Park"

6. Masat zbutese per ndikimet ne Cilesine e tokës

Masat zbutëse përfshijnë:

- Përdorimi i rrugëve ekzistuese si rrugët hyrëse në sektorin e punimeve;
- Rrethimi i sheshit të ndërtimit për të minimizuar demtinin e terrenit në zonën periferike;
- Kryerja e punimeve të ndërtimit gjatë periudhave të thata, kur toka nuk është e ngopur;
- Zbatimi i praktikave më të mira për zbutjen e ndotjes së tokës nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme.

Efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar me probabilitet të ulët duke mos marrë parasysh tjetërsimin e përdorimit të saj si dhe me shtrirje lokale Zbutja mund të bëhet përmes planifikimit për përdorimin e rrugëve ekzistuese hyrëse; Rehabilitimi i terrenit pas punimeve të ndërtimit nga ngjeshjet e krijuara.

Pasi janë zbatuar masat e duhura zbutëse, ndikimi i përgjithshëm mbi cilësinë e tokës mund të vlerësohet të një rëndësie të vogël dhe të masë të kufizuar.

7. Tektonia dhe sizmiteti

Të aplikohen praktikat më të mira ndërkombëtare në lidhje me kushtet gjeoteknike për ndërtimin e objektit. Në përputhje me Eurokodi 8, është e rekomanduar ndërmarrja e njëstudimi të detajuar gjeoteknik dhe sizmologjik për vendin e ndërtimit;

Do të jetë e nevojshme zbatimi i praktikave më të mira të përcaktuara në fazën e projektimit gjatë ndërtimit të komponentëve të projektit të propozuar.

8. Gjeologjia

Masat zbutëse përfshijnë:

- Aplikimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në lidhje me vlerësimin gjeoteknik të vendit të projektit
- Masat e propozuara duhet të merren për të siguruar praktika më të mira gjatë fazës së ndërtimit të projektit të propozuar. Aktivitetet e projektit duhet të marrë në konsideratë parametrat gjeologjike dhe kategorinë e tokës për të shmangur ndonjë ndikim eventual negativ të tilla si lëngëzimi i tokës, rrëshqitje, erozionit sedimentimit etj. Keto ndikime vlerësohet me probabilitet të ulët, me madhësi të shtrirjen lokale.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: "Krijimi I Shtegur Turistik Liqeni I Deges – Liqeni I Merhojes- Kompleksi Eco Park"

Ato mund të zbuten duke shmangur rrëshqitje të tokës shkaktuara nga punimet e ndërtimit. Me marrjen e masave zbutëse përmendura më sipër, ndikimet e mundshme do të vlerësohen të papërfillshme.

9. Masat zbutese per ndikimet ne cilesine e ajrit

Masat zbutëse të rekomanduara janë:

- Shmangja e përdorimit të rrugëve në të gjithë zonën e banuar, nga kamionë të transportit. Shmangja sa më shumë që është e mundur e kalimit të kamionëve të transportit të rëndë në të zonën e banuar;
- Mbulimi i kamioneve të transportit dhe stoqeve të matërialeve për të evituar ndikimin e përhapjes së pluhurave nga era;
- Spërkatje e stoqeve dhe rrugët e hyrjes me ujë, gjatë sezonit të thatë për të minimizuar pluhurin;
- Sigurimi i pajisjeve personale mbrojtëse për punëtorët për të minimizuar rrezikun nga pluhuri dhe të tjera substancave ndotëse;
- Të sigurohet që të gjitha automjetet e ndërtimit të jenë nënshtruar mirëmbajtjes së rregullt dhe të përshtatshme në kushtet teknike, në përputhje me specifikimet e sipas prodhuesve e standarteve;
- Përdorimi lëndëve djegëse, të cilat janë në përputhje me standardet zyrtare
- Monitorimi i cilësisë së ajrit në bazë të VKM Nr.435, të 12.09.2002, "Për normat e shkarkimeve në ajër, në territorin e Shqipërisë", VKM Nr 803, dhjetor 2003, "Për normat e cilësisë së ajrit" dhe VKM Nr 103, i 31.3.2002, "Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë". Udhëzimi nr.6527 datë 24.12.2004 "Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyra të kontrollit të tyre" përcakton kufijtë e lejueshëm të elementeve ndotës të ajrit në mjedis, që shkarkohen me gazet, nga përdorimi dhe trafiku i automjeteve rrugore, si dhe i kufirit të zhurmave të ndotjes akustike shkaktuar për të njëjtën arsye;

Konkluzion: Ndikimi, i aktiviteteve të projektit në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndërtimit, është i përkohshëm, i kthyeshëm, dhe i lokalizuar në vendin e punës. Ky ndikim ndikon në mjedisin lokal në afërsi objektit të segmentit rrugor shtesë dhe mund të zbutet duke marrë masat e duhur.

10. Masat zbutese per ndikimet ne Zhurma

Masat zbutese lidhen me respektimin e standarteve ligjore gjate ndertimit e operimit te objektit te propozuar.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: "Krijimi I Shtegur Turistik Liqeni I Deges – Liqeni I Merhojes- Kompleksi Eco Park"

Ligji Shqiptar Nr 9774, i 12.7.2007; "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis" - neni 10, parashikon që masat për mbrojtjen nga zhurma të zbatohen në varësi të kohës kur zhurmat janë të krijuar. Për këtë qëllim, 24 orët ndahen si më poshtë:

- Dita zgjat 13 orë, nga 06:00 deri në 19:00;
- Mbrëmja zgjat 4 orë, nga 19:00 deri në 23:00;
- Nata zgjat 7 orë, nga 23:00 në 06:00.

Kufijtë për nivelet e pranueshme të zhurmës në zonat e banuara, janë specifikuar në Rregulloren e përbashkët të MMPAU dhe MSH, Nr.8, të 27.11.2007 "Mbi përcaktimin e kufijve për zhurmave në mjedise të caktuara",

Tabela: Nivelet e brezit të zhurmës në varësi të mjedisit(sipas udhezimit nr.8, date 27.11.2007 per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara).

Mjedisi	Efekti kritik ne shendet	LAeq (dBA)	Koha baze (ore)	LAmx Fast (dB)
Zona banimi				
Jashte banese	Bezdi (shqetesim) serioze gjate dites dhe mbremjes	55	16	
	Bezdi (shqetesim) i moderuar gjate dites dhe mbremjes	50	16	
Ne brendesi te banesave	Kuptueshmeri e bisedes dhe (bezdi) shqetesim i moderuar gjate dites dhe mbremjes	35	16	
Ne brendesi te dhomes se fjetjes	Prishja e gjumit naten	30	8	
Jashte dhomes se fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlere nga jashte)	45	8	
Institucione				
Klasa mesimi institucione-mjedise parashkollore(brenda)	Kuptueshmeri e bisedes, veshtiresi ne kuptimin e informacionit, komunikimin e mesazhit	35	Gjate mesimit	
Dhoma te fjetjes ne kopshte (brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-
Oborri I shkolles, vendet e lojravene Shkolle	Bezdi (shqetesim) - (burime te jashteme)	55	Koha e pushimit	-
Spitale,salla,dhoma(brenda)	Prishja e gjumit naten Prishja e gjumit dite dhe ne mbremje	30	8	40
		30	16	
Spitale,salla trajtimi(brenda)	Ndikim ne pushim, clodhje	#1		
Zona me aktivitetet social- ekonomik				
Zona industriale,tregtare,qarkullimi	Demtim degjimi	70	24	110

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: "Krijimi I Shtegur Turistik Liqeni I Deges – Liqeni I Merhojes- Kompleksi Eco Park"

Trafiku (mjedis i jashtem dhe i brendshem)				
Mjedis urban				
Mjedise publike, te jashtme apo te rendshme	Dentim degjimi	85	1	110
Ceremoni, festival dhe argetime	Dentim degjim (klientet<5here/vit)	100	4	110
Muziken e permjet kufjeve te degjimit	Dentim degjimi	85#4	1	110
Tinguj- zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe arme te zjarrit	Dentim degjimi (te rriturit) Dentim degjimit (femijet)	-	-	140#2 120#2
Parqe publike				
Parqet natyrore dhe zona te mbrojtura	Prishje e qetesise	#3		

Shpjegime:

$L_{Aeq}(dBA)$ =Niveli ekuivalent i matur ne shkallen A

Koha baze (ore) = Koha gjate se ciles behet matja

L_{Amax} Fast (dB) = Niveli i matur ne shkallen A ne menyren Fast (e shpejte)

#1 = Sa me e ulet qe te jete e mundur.

#2 = Presioni zanor maksimal (L_{Amax} , fast) matur 100 mm larg veshit.

#3= Zonat e jashteme te qe ta duhet te mbrohen dhe raporti i zhurmes hyrese/shtese me zhurmen e fonit natyral duhet te ruhet sa me i ulet qete jete e mundur.

#4 = Nen kufjet e degjimit,pershtatur me vlerat fushes se lire.

11. Masat zbutese per ndikimet ne Vibrimet

Masat lehtësuese sugjeruara përfshijnë:

- Të sigurohet që shpërndarja e materialeve të ndërtimit në sheshin e ndërtimit është e përfunduar vetëm gjatë orëve të dites;
- Kryerja e inspektimeve të rregullta dhe mirëmbajtja e motorëve të ndërtimit dhe mjeteve të transportit;
- Të sigurohet që punëtorët janë të përdorin pajisje të mbrojtjen nga zhurma;

Konkluzion:

Ndikimet negative nga zhurmat dhe vibrimet e krijuara gjatë fazës së ndërtimit janë të përkohshme dhe të lokalizuara në vend të punës dhe të rrugëve të transportit. Ata janë vlerësuar të jenë te pranueshme me amplitude te vogلة dhe mund te zbuten me marrjen e masave te pershtatshme te propozuara.

12.Masat zbutese per ndikimet ne Peisazh dhe çeshtjet vizuale

Masat zbutëse të propozuara:

- Mundësimi në mënyrë sa më maksimale në kushtet e objektit të përdroimit të gjelberimit; Minimizimin e zonave që përdoren përkohësisht për qëllime ndërtimi;
- Minimizimi i ndërtimeve eventuale të qasjes së re të rrugeve hyrese në objekt dhe përdorimit të sa më shumë të jetë e mundur rrugët ekzistuese duke respektuar kushtet e rrugore te përdorimit;
- Shmangia sa më shumë të jetë e mundur e rreziqeve gjeologjike të tilla si erozioni, rrëshqitjet e tokës gjatë ndërtimit.

Konkluzion:

Gjatë fazës parapregatitore të terrenit, atë të ndërtimit si dhe venies në funksion ndikimi vlerësohet me probabilitete të ulët e të moderuar në madhësinë dhe shtrirjen lokale të vepres ngjitur me segmentin egzistues. Ndikimi mund të zbutet pjesërisht nëse zbatohen masat e duhura zbutëse.

13.Masat zbutese per ndikimet nga Përmbytje

Masat zbutëse te propozuara:

Mirëmbajtja e rrjetit të kullimit dhe kanalizimeve me të cilat lidhet sheshi i ndërtimit dhe objekti.

Konkluzion:

Në zonën e objektit të propozuar ndikimi i mundshëm nga përmbytjet mund të vlerësohet i ulët, me probabilitetit të moderuar, e madhesi të vogël e mesem e shtrirje lokale. Nëse merren masat e duhura zbutëse, këto ndikime mund të reduktohet në një probabilitet të ulët.

8. Çështjet socio-ekonomike

Përdorimi i tokës

Nuk parashikohen demtime të pronave afër objektit, në rast demtimi ato duhet të kompensohen ose duhet të restaurohen në gjendjen e mëparshme.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: "Krijimi I Shtegur Turistik Liqeni I Deges – Liqeni I Merhojes- Kompleksi Eco Park"

Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës

Politika e kompanisë sonë në lidhje me sigurinë është "Synimi Zero" për të gjitha Incidentet ose Aksidentet. Për të arritur këtë objektiv, kushtet dhe masat paraprake të renditura më poshtë do të ndiqen për të gjithë stafin tonë të përhershëm dhe të gjithë vizitorët.

1. Lejet e kërkuara do të merren nga autoritetet përkatëse përpara fillimit të punimeve.
2. Të gjitha punimet do të kryhen sipas udhëzimeve të përcaktuara në planin specifik të projektit HSSE.
3. I gjithë personeli i përfshirë në projekt do të përfshihet në çështjet e sigurisë shëndetësore dhe mjedisore që lidhen me punën.
4. Rëndësi maksimale do t'i kushtohet sigurisë së personelit dhe mbrojtjes së Shërbimeve ekzistuese mbi/nëntokësore. Do të sigurohet që personeli i përfshirë të jetë plotësisht i vetëdijshëm për rregulloret e "Kontraktorit"/Sigurisë së Punëdhënësit. Për të arritur sa më sipër, do të sigurohet gjithashtu:
5. Takimet e kutisë së veglave do të zhvillohen përpara fillimit të punimeve.
6. Vetëm personeli i trajnuar me përvojë përkatëse do të lejohet të trajtojë makineritë.
7. Tabelat e përshtatshme të sigurisë, barrierat dhe ndriçimi dhe masa të tjera mbrojtëse do të sigurohen siç kërkohet nga natyra dhe vendndodhja e punimeve. Të gjitha operacionet duhet të kryhen në përputhje me kërkesat e sigurisë.
8. I gjithë personeli në terren do të përdorë pajisjet e sigurisë PPE si këpucë sigurie, helmeta, mbulesa të tëra, syze dhe maskë pluhuri, etj. sipas nevojës.
9. Nëse ndriçimi natyral nuk është i mjaftueshëm, do të instalohet ndriçimi artificial.
10. Impiantet & Pajisjet do të testohen dhe certifikohen plotësisht nga një agjenci e pavarur testimi. Kopjet e certifikatave do t'i dorëzohen departamentit përfaqësues.
11. Punonjësit do të mbajnë distanca të sigurta nga automjetet dhe makineritë në lëvizje.
12. Ata gjithashtu nuk do të pushojnë në vende të rrezikshme
13. Zonat e rrezikshme do të rrethohen dhe sinjalizohen ndërsa materialet dhe ndotësit do të largohen nga kantieri nga kompani të specializuara që do të kontraktohen nga ne në varësi të llojit të materialit ndotës. Dherat që nuk do të ripërdoren do të depozitohen në zonat e përcaktuara pas lejes së dhënë nga institucionet përkatëse.
14. Zona do të jetë e shënuar qartë dhe tabelat e shenjave duhet të rregullohen për të shmangur çdo aksident të mundshëm.
15. Njerëzit nuk do të lejohen të punojnë në zonën ku janë duke u zhvilluar punë stresuese.
16. Inxhinieri/Mbikqyrësit e sitit do të sigurohen që platformat e nevojshme të jenë të disponueshme për njerëzit për të kryer punë stresuese përpara fillimit.
17. Stafi i kantierit duhet të sigurohet që presioni i tepërt të mos ushtrohet gjatë punëve stresuese që mund të çojnë në thyerjen e fijeve/tendonave.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: "Krijimi I Shtegur Turistik Liqeni I Deges – Liqeni I Merhojes- Kompleksi Eco Park"

Ne ketë rregullore percaktohen:

Detyrimet e punëdhënesit

Punëdhënesi vetë ose nepermjet drejtuesit teknik duhet t'u bëjë të ditur punëmarrësve:

- Pajisjet dhe automjetet që përdoren në operacionet e ngarkim shkarkimit.
- Shkaqet e aksidenteve dhe masat për menjanimin e tyre sipas specifikës së aktivitetit.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, të leshuara nga dikasteret që lidhen me to.
- Veçoritë e punës në, rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes për menjanimin e aksidenteve sidomos në kushte të veçanta (reshje, lageshtire etj).
- Rregullat e sigurimit teknik që lidhen me proceset e punës, makineritë dhe profesionin që kryen punëmarrësi, për mbrojtjen e vetes dhe punonjesve të tjerë, të cilët kryejnë këtë aktivitet ose të tjerë që janë vizitore.
- Ndihmen e parë shëndetsore
- Të kryejnë instruktim paraprak dhe periodik i punonjesve, dokumentat sipas formularit të përcaktuar në rregulloren e sigurimit teknik për operacione specifike ngarkim shkarkimi.

Detyrimet e punëmarrësit:

- Të njohë mirë përdorim e pajisjeve dhe makinerive për shfrytëzimin e tyre.
- Të njohë dhe zbatojë rregulloret e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë të publikuara nga Inspektoriati i Sigurimit Teknik dhe Inspektoriati i Punës.
- Të dije mirë shkaqet e mundshme të aksidenteve për çdo proces pune.
- Të sigurojë vehtënë e punonjesit të tjerë gjatë procesit të punës.
- Kur konstaton shenja të një avarie të mundshme që është burim aksidenti, në radhë të parë, merr masa për eliminimin e saj, ndërkohë lajmëron gjithë punonjesit për rrezikun.
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes individuale në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme për ndihmën e shpejtë.

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: "Krijimi I Shtegur Turistik Liqeni I Deges – Liqeni I Merhojes- Kompleksi Eco Park"

Ndikimi në komunitet, shëndeti dhe siguria

Është e rëndësishme që komuniteti të njohe e të jetë i informuar në lidhje me vendin e zbatimit të projektit për arsye të levizjeve të paautorizuara që mund të ndodhin në vendet e ndërtimit nga fëmijët dhe të rriturit e qëmund të shkaktojë pasoja të rënda për keta individëve. Rrethimi i sheshit të ndërtimit dhe mbajtja nën kontroll rrit masat e sigurisë në këtë drejtim. Zhvilluesi do të jetë i detyruar për të zhvilluar dhe zbatuar procedurat për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e publikut.

Kjo do të përfshijë trajnime për punëtorët dhe personelin e sigurisë për të parandaluar qasje të paautorizuara në vendet e ndërtimit, zonat e qarkullimit të mjeteve të ndërtimit, si dhe zonat e magazinimit të pajisjeve.

Konkluzion: Nëse zbatohen masat e duhura, ndikimi i përgjithshëm mund të vlerësohen të një rëndësie të ulët.

Gjenerimi i mbetjeve

Per zbutjen e ndikimeve propozohen keto masa:

Ujërat e zeza te zyrave duhet të largohen në destinacione të përshtatshme, nga subjekte të liçensuara e të monitoruara nga DRM dhe autoritetet lokale.

Ndikimet e përkohshme e ujërave të zeza të gjeneruara nga aktivitetet e projektit mund të zbutet duke zbatuar një Plan Menaxhimi Mjedisor për ujërat e zeza.

Mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme

Ndikimet e përkohshme e mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme mund të zbutet duke zbatuar një planin e menaxhimit për mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme, të cilat duhet të jenë të përgatitur para se të periudhës së ndërtimit, dhe në përputhje me:

Ligjin me Nr.10 463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar" i cili synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet menaxhimit të integruar të mbetjeve; Ligjin Nr 9537, datë 18.05.2006, "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme"; dhe VKM Nr 103, të 31.03.2003, "Për monitorimin e mjedisit".

Raporti Paraparak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
Objekti: "Krijimi I Shtegur Turistik Liqeni I Deges – Liqeni I Merhojes- Kompleksi Eco Park"

Per zbutjen e impakteve ne tokë sherben sistemimi e organizimi i përshtatshem i mjedisit të punës. Firma zbatuese duhet të marri masa e përgjegjesitë për administrimin e përshtatshëm të mbetjeve sipas rastit e natyrës së tyre.

Konkluzion: Mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme nga aktivitetet e ndërtimit mund të zbutet. Ndikimi i tyre është i përkohshëm, nëse veprimet e nevojshme rehabilitimit janë marrë.

Shkarkimimi i mbetjeve do të kryhet në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menazhimin e mbetjeve inerte".

Zotëruesi i mbetjeve inerte, i cili kryen përpunim paraparak, përzierje apo procese të tjera, që ndryshojnë natyrën ose përbërjen e këtyre mbetjeve, është i detyruar t'i ruajë, t'i transportojë dhe t'i dorëzojë ato në lëndfill apo në venddepozitim të përkohshëm në mënyrë të diferencuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme", si dhe vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

Zotëruesi i mbetjeve inerte është i detyruar t'i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".

Zotëruesit e mbetjeve inerte dhe operatorët e lëndfilleve të mbetjeve inerte janë të detyruar të plotësojnë dhe të nënshkruajnë dokumentin e transferimit të këtyre mbetjeve dhe të dhënat regjistrohen në Regjistrin e Transfertave Individuale, sipas vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

Raporti Paraprak I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:

Objekti: "Krijimi I Shtegur Turistik Liqeni I Deges – Liqeni I Merhojes- Kompleksi Eco Park"

Subjekti fizik/juridik, që prodhon mbetje inerte gjatë ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes së objektit, është përgjegjës për dëmet e drejtpërdrejta ndaj palëve të treta që dëmtohen nga ushtrimi i aktivitetit të tyre dhe nga detyrimet kontraktuale.

Në vendin për depozitim të përkohshëm të mbetjeve inerte, të depozitohen jo më tepër se 20 tonë në ditë ose 3000 - 3500 tonë në vit mbetje inerte. Afati i dorëzimit të mbetjeve inerte në venddepozitim të përkohshëm të jetë deri në momentin e ndërtimit të lëndës për trajtimin e mbetjeve inerte në zonën më të afërt gjeografikisht të njësisë së qeverisjes vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në venddepozitim të përkohshëm ose lëndëfillët e trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për ton/mbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore.

Evadimi i dherave e mbetjeve te tjera te ndertimit

Shoqëria investitore me shpenzimet e veta do të kryejë evadimin e dherave dhe mbetjeve të tjera të ndërtimit që do të dalin gjatë hapjes së gropës së themeleve. Grumbullimi dhe transportimi i dherave do të bëhet konform kërkesave dhe rregullave mjedisore. Ato do të evadohen brenda ditës, për të mos penguar punimet e metejshme e për të mos ndotur mjedisin.

Evadimi ne menyre te vazhdueshme i te gjitha mbeturinave qe do te krijohen gjate punes

Mbeturinat e ngurta, me natyrë dhe perberje, do të jenë mbeturina inerte të tilla si gure, leter, qelq, mbeturina llaçi tulle etj. Për grumbullimin e mbeturinave do të mbahen konteniere të veçanta brenda rrethimit të objektit dhe me vone do të evadohen brenda ditës për të mos penguar punimet e metejshme e ndotur mjedisin. Do të meren masa për lagjen e mbeturinave ndërtimore meqenëse punimet kryhen në një nga zonat e banuara të qytetit.

Projektues

"INSITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM (IKN)" SHPK



Email: info@iknshpk.al Cel: 355 68 208 0951